



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.131

28 shtator

2010

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.728, datë 1.9.2010	Për shpalljen e zonave arkeologjike “A” e “B” të qytetit të Lezhës dhe miratimin e rregullores së administrimit	6949
Vendim i KM nr.729, datë 1.9.2010	Për shpalljen e zonave arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Vlorës dhe miratimin e rregullores së administrimit	6953
Vendim i KM nr.730, datë 8.9.2010	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit të znj.Naida Kapo, në Itali	6957
Vendim i KM nr.732, datë 1.9.2010	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Shëngjergj të qarkut të Tiranës	6958
Vendim i KM nr.733, datë 1.9.2010	Për një shtesë në vendimin nr.591, datë 23.7.2010 të Këshillit të Ministrave “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore”, të ndryshuar	6959
Vendim i KM nr.735, datë 1.9.2010	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Terpan të qarkut të Beratit	6959
Vendim i KM nr.736, datë 8.9.2010	Për një ndryshim në vendimin nr.1293, datë 29.12.2009, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kryetarit dhe emërimin e anëtarëve, përfaqësues të pushtetit qendror, në këshillin drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit”	6960
Vendim i KM nr.738, datë 8.9.2010	Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të shitjes së trojeve në përdorim, sipërfaqe të domosdoshme dhe shtesë funksionale të ndërmarrjeve, shoqërive apo të objekteve shtetërore, të veçuara, të privatizuara dhe të ndërtesave të ndërtuara në bazë të lejeve të ndërtimit	6961

Udhëzim i MMPAU nr.3, datë 20.8.2010	Për standardizimin e formatit të aktit të miratimit të lejeve dhe autorizimeve mjedisore	6965
Udhëzim i MPPT nr.16, datë 25.8.2010	Për disa shtesa e ndryshime në udhëzimin nr.1649, datë 16.8.1999 “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve”, të ndryshuar	6969
Udhëzim i MPÇSSHB nr.1730, datë 27.8.2010	Për zbatimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për personat me aftësi të kufizuar në qendrat rezidenciale dhe ditore	6973
Udhëzim i MF nr.33, datë 24.9.2010	Për trajtimin e kredive të transferuara nga bankat e nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror në Agjencinë e Trajtimit të Kredive, kriteret dhe kushtet për ndryshimin e marrëveshjes së kredisë, si dhe procedurat e marrjes në pronësi të pasurive të lëna si garanci ose jo nga huamarrësit, të administrimit, shitjes dhe dhënies me qira apo me enfiteozë të këtyre pasurive	6977

VENDIM
Nr.728, datë 1.9.2010

**PËR SHPALLJEN E ZONAVE ARKEOLOGJIKE “A” E “B” TË QYTETIT TË LEZHËS DHE
MIRATIMIN E RREGULLORES SË ADMINISTRIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 31, pika 1, e 53, pikat 1 e 2, të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e zonave arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Lezhës, sipas hartës dhe koordinatave gjeografike, të përcaktuara në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Miratimin e rregullores së administrimit të zonave arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Lezhës, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Në pikën 1 të vendimit nr.6, datë 7.1.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e zonave arkeologjike, brenda qendrave të banuara në Shkodër, Lezhë, Krujë, Durrës, Elbasan, Berat, Vlorë dhe Sarandë”, zonifikimi për qytetin e Lezhës shfuqizohet.

4. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Brendshme, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe organet e njësisë së qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE
PËR ADMINISTRIMIN E ZONËS ARKEOLOGJIKE “A” DHE “B” TË QYTETIT TË LEZHËS

Neni 1

Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e rregullave për administrimin e zonës arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Lezhës, mbështetur në ligjin nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, i ndryshuar.

Neni 2

Kategoritë e zonës arkeologjike

Zona arkeologjike e qytetit të Lezhës, në varësi të intensitetit dhe rëndësisë së gjetjeve arkeologjike, kategorizohet në zona arkeologjike “A” dhe zona arkeologjike “B”.

Neni 3

Ndërhyrjet në zonën arkeologjike “A” të qytetit të Lezhës

Në zonën arkeologjike “A” të qytetit të Lezhës lejohet:

1. Restaurimi dhe konservimi i monumenteve dhe strukturave arkeologjike, kryerja e sondazheve arkeologjike me synim studimin e plotë të zonës, mbi bazën e projekteve të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.

2. Rikonstruksioni i rrugëve dhe të gjitha punimet në rrjetin inxhinierik ujësjellës-kanalizime, ndriçim, telefoni, mbi bazën e projekteve të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.

3. Vendosja e konstruksioneve të lehta (dru, xham, plastikë, metal) me lartësi maksimale 3 m, të cilat duhen realizuar larg mureve dhe strukturave të tjera të dallueshme apo të supozuara. Konstruksionet vendosen dhe përdoren nga institucionet shtetërore të specializuara, duhet të jenë të lëvizshme (të çmontueshme) dhe që në asnjë rast nuk duhet të dëmtojnë nëntokën dhe peizazhin, në funksion të ruajtjes, ekspozimit, informimit publik dhe nevojave të tjera që lidhen me veprimtarinë arkeologjike në veçanti dhe trashëgiminë kulturore në përgjithësi. Projekti miratohet nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve dhe për çdo rast duhet të përcaktojë saktësisht qëllimin, kohëzgjatjen, vendndodhjen e strukturës brenda zonës, si dhe planprojektin e saj.

Neni 4

Ndërhyrjet në zonën arkeologjike “B” të qytetit të Lezhës

Në zonën arkeologjike “B” të qytetit të Lezhës lejohen:

1. Ndërtimet e reja pas miratimit me shkrim nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë të kërkesave të subjekteve të interesuara.

2. Ndërtimet lejohen vetëm pas kryerjes paraprake nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik të vëzhgimit intensiv, sondazheve arkeologjike apo formave të tjera të testimit në varësi të potencialit që përfaqëson zona me miratim të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë.

3. Format e testimit përcaktohen nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, por kryesisht janë sondazhe që nuk cenojnë shtresat në rast të vijimit të gërmimit arkeologjik, studime gjeofizike, regjistrim digjital i terrenit, vëzhgim intensiv arkeologjik etj.

4. Në rastet kur gjatë zbatimit të projektit ndërtimor zbulohen gjetje të rëndësishme të veçantë, projekti duhet të rishikohet. Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë miraton ndryshimet në projekt, duke marrë në konsideratë konservimin, ruajtjen, si dhe bërjen e tyre të vizitueshme. Vetëm pas miratimit të ndryshimeve lejohet vazhdimi i punimeve.

Neni 5

Procedurat që ndiqen për ndërhyrjet ndërtimore në zonën arkeologjike “B”

1. Për çdo ndërhyrje që prek nëntokën, në zonat arkeologjike “B”, subjekti ndërtues i interesuar vë në dijeni Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare, përgjegjëse për qytetin e Lezhës, Zyrën e Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Arkeologjik, Lezhë dhe paraqet pranë Sekretarisë Teknike të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë dokumentacionin si më poshtë:

- Fotokopje e noterizuar e lejes së sheshit të ndërtimit nga KRRT/KRRTRSH;

- Fotokopje e noterizuar e vendimit të gjykatës ose regjistrimit në QKR;

- Prokurë për personin e autorizuar për nënshkrimin e kontratës, nëse nuk është administratori i subjektit.

2. Pas shqyrtimit dhe miratimit të kërkesës së subjektit nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë, Agjencia e Shërbimit Arkeologjik nënshkruan një kontratë me subjektin, për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve.

Neni 6

1. Për ndërhyrjet pa leje brenda zonës arkeologjike “B”, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, përgjegjëse për qytetin e Lezhës, pezullon menjëherë veprimtarinë e subjektit dhe njofton Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, Institutin e Monumenteve të Kulturës dhe strukturën përgjegjëse për trashëgiminë kulturore në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

2. Në rast se subjekti nuk pezullon veprimet brenda 24 orëve, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare përgjegjëse i drejtohet menjëherë Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor dhe Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar për pezullimin e ndërtimit deri në prishjen e tij.

Neni 7

Shkeljet e procedurave nga subjektet e licencuara

Në rast të shkeljeve të procedurave nga subjektet ndërtimore, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë për subjektin, si dhe për drejtuesin teknik përkatës, nuk merr në shqyrtim për një periudhë 3-vjeçare asnjë kërkesë për ndërtim në zona arkeologjike "B" në të gjithë territorin e vendit, apo në zona të tjera, ku sipas ligjit kërkohet miratimi i Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë.

Neni 8

Gjetjet arkeologjike

1. Klasifikohen si gjetje arkeologjike, objektet e luajtshme dhe të paluajtshme në kontekstet arkeologjike, struktura murale (varre monumentale, pjesë mozaiku të shtrirë në një sipërfaqe mbi 4 m², afreske, ndërtime inxhinierike, pjesë arkitekturore që lidhen me strukturat murale dhe banesa, tempuj e godina të tjera shërbimesh).

2. Në rast gjetjesh të rëndësishme të paluajtshme, punimet e nisura pezullohen menjëherë nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik. Brenda afatit prej 10 ditësh nga ndërprerja e punimeve, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë vendos për veprimet e mëtejshme. Veprimet e mëtejshme, në lidhje me vazhdimin e ndërtimit, do të ndërmerren nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik në cilësinë e Sekretarisë Teknike të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë, jo më vonë se 30 ditë nga ndërprerja e punimeve. Nëse gjetjet janë me vlera të rëndësishme, punimet e filluara të ndërpriten përfundimisht. Vendimi në këtë rast merret nga organi që ka autorizuar fillimin e punimeve, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë.

3. Në rast se Agjencia e Shërbimit Arkeologjik i propozon ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore shpalljen monument kulture të një objekti të paluajtshëm, Instituti i Monumenteve të Kulturës bën studimin e zonës mbrojtëse të saj brenda 30 ditëve nga zbardhja e vendimit për shpalljen monument kulture.

4. Shpenzimet për kryerjen e hulumtimeve të nevojshme, përgatitjen e dokumentacionit, si dhe për ndryshimet e mundshme të projektit kur vendoset që gjetjet të mbrohen në vend (*in situ*), të gjitha shpenzimet për to, si dhe shpenzimet për kërkimet shkencore, veprimtaritë e nevojshme restauruese ose konservuese mbulohen 100% nga investitori.

5. Në rast të gjetjeve arkeologjike të rëndësishme, kur Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë vendos ndërprerjen përfundimtare të punimeve, investitori shpronësohet në bazë të kuadrit ligjor në fuqi.

Neni 9

Gërmimet e shpëtimit

1. Në rast gjetjesh arkeologjike, zhvillohet gërmim i shpëtimit. Gërmimi i shpëtimit kryhet nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare, përgjegjëse për qytetin e Lezhës, Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Arkeologjik, Lezhë ose nga subjekte private me leje të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë, nën mbikëqyrjen e Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.

2. Në rast se gjatë kryerjes së gërmimit të shpëtimit gjykohet e nevojshme asistencë shkencore dhe teknike në terren e specialistëve të Institutit të Arkeologjisë, kërkohet zyrtarisht pjesëmarrja e tyre në gërmim.

3. Nëse pas kryerjes së gërmimit të shpëtimit zbulohen gjetje të rëndësishme të veçantë (strukturë etj.) Agjencia e Shërbimit Arkeologjik pezullon gërmimin dhe propozon në Këshillin Kombëtar të Arkeologjisë ndryshimet në projekt, me synim mbrojtjen dhe bërjen të vizitueshme të këtyre vlerave.

4. Vazhdimi i punimeve ndërtimore lejohet mbas verifikimit nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik të përmbushjes së kriterëve të vendosura nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë për zbatimin korrekt të projektit të mbrojtjes dhe vizitueshmërisë.

5. Në përfundim të çdo gërmimi shpëtimi përgatitet një relacion i plotë, i cili i paraqitet Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë për miratim brenda 30 ditëve. Pas shqyrtimit dhe miratimit, një kopje e relacionit të plotë depozitohet edhe pranë Institutit të Arkeologjisë.

6. Në rastin kur gërmimi i shpëtimit kryhet nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, relacioni firmoset nga drejtuesi i grupit dhe nga anëtarët e tij, si dhe konfirmohet nga drejtori i Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.

7. Në rastin kur gërmimi i shpëtimit kryhet nga një subjekt privat, relacioni firmoset/konfirmohet nga drejtuesi i projektit të subjektit, minimumi 2 arkeologë të këtij subjekti dhe nga specialisti i autorizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, i cili ka qenë prezent gjatë gërmimit.

Neni 10

1. Vëzhgimi intensiv sipërfaqësor (*survey*) dhe sondazhet arkeologjike kryhen nga specialistë të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik, në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare, përgjegjëse për qytetin e Lezhës dhe Zyrën e Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Arkeologjik, Lezhë. Në çdo projekt të ndërmarrë nga subjektet, është e detyrueshme pjesëmarrja e një përfaqësuesi të autorizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik.

2. Kur subjekti privat kryen shkelje duke mos respektuar legjislacionin në fuqi, Agjencia e Shërbimit Arkeologjik pezullon gërmimin dhe relaton menjëherë në Këshillin Kombëtar të Arkeologjisë, duke propozuar edhe masat përkatëse. Agjencia e Shërbimit Arkeologjik vulos kantierin dhe e monitoron atë në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare, përgjegjëse për qytetin e Lezhës dhe Zyrën e Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Arkeologjik, Lezhë.

3. Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë pasi shqyrton rastin vendos:

- a) Lënien në fuqi të vendimit të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik për pezullimin e punimeve;
- b) Shfuqizimin e vendimit për pezullim dhe lejimin e vijimit të punimeve.

4. Në rastet kur subjekti privat nuk e kryen gërmimin sipas kuadrit ligjor në fuqi, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë i delegon Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik të vazhdojë gërmimet.

5. Vendimi i Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë është i formës së prerë.

Neni 11

Vendosja e tabelave prezantuese dhe paneleve shpjeguese

1. Në zonën arkeologjike “A” dhe “B” vendosja e tabelave prezantuese dhe paneleve shpjeguese për monumente të veçanta, rrënoja apo hapësira me potencial arkeologjik, bëhet vetëm në vendet e përcaktuara sipas rastit nga Instituti i Monumenteve të Kulturës dhe Agjencia e Shërbimeve Arkeologjike dhe zbatohet nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, përgjegjëse për qytetin e Lezhës dhe Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Arkeologjik, Lezhë.

2. Në asnjë rast tabelat prezantuese dhe panelet shpjeguese nuk duhet të dëmtojnë apo konkurrojnë monumentin.

3. Vendosja e tabelave të sinjalistikës rrugore/turistike pranë monumenteve dhe zonave të mbrojtura rreth tyre bëhet në mbikëqyrjen e Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare, përgjegjëse për Lezhën.

4. Për çdo veprimtari me karakter kulturor në zonat arkeologjike “A” dhe “B”, vendosja e tabelave dhe e materialeve publicitare lejohet në raste të veçanta festivo-kulturore dhe ka karakter të përkohshëm. Vendosja e tyre ekzekutohet vetëm në zbatim të urdhrit të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe nën mbikëqyrjen e Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare, përgjegjëse për Lezhën dhe Zyrës së Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Arkeologjik, Lezhë.

5. Është e ndaluar vendosja e posterave publicitarë (jokulturorë) dhe politikë, si dhe dëmtimet e tjera të monumenteve dhe rrënojave arkeologjike (vizatimi, shkrimi mbi strukturat e paluajtshme).

Neni 12

Kjo rregullore shoqërohet me hartën e zonifikimit, e cila rishikohet nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik periodikisht, bazuar në të dhënat e reja arkeologjike, si dhe nevojën për mbrojtjen e monumenteve.

Neni 13

Në studimet urbanistike për qytetin e Lezhës duhet të merret parasysh zonifikimi arkeologjik i qytetit të Lezhës dhe përcaktimet e kësaj rregulloreje.

Studimet urbanistike të miratuara që janë në fazën e zbatimit, si dhe rregulloret përkatëse të tyre, duhet të rishikohen nga njësia e qeverisjes vendore Lezhë, me qëllim që të zbatohet zonifikimi arkeologjik i qytetit të Lezhës dhe përcaktimet e rregullores përkatëse.

VENDIM Nr.729, datë 1.9.2010

PËR SHPALLJEN E ZONAVE ARKEOLOGJIKE “A” DHE “B” TË QYTETIT TË VLORËS DHE MIRATIMIN E RREGULLORES SË ADMINISTRIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 31, pika 1, e 53, pikat 1 e 2, të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e zonave arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Vlorës, sipas hartës dhe koordinatave gjeografike, të përcaktuara në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Miratimin e rregullores së administrimit të zonave arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Vlorës, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Në pikën 1 të vendimit nr.6, datë 7.1.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e zonave arkeologjike, brenda qendrave të banuara në Shkodër, Lezhë, Krujë, Durrës, Elbasan, Berat, Vlorë dhe Sarandë”, zonifikimi për qytetin e Vlorës shfuqizohet.

4. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Brendshme, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe organet e njësisë së qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Sali Berisha**

RREGULLORE PËR ADMINISTRIMIN E ZONËS ARKEOLOGJIKE “A” DHE “B” TË QYTETIT TË VLORËS

Neni 1

Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e rregullave për administrimin e zonës arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Vlorës, mbështetur në ligjin nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, i ndryshuar.

Neni 2

Kategoritë e zonës arkeologjike

Zona arkeologjike e qytetit të Vlorës, në varësi të intensitetit dhe rëndësisë së gjetjeve arkeologjike, kategorizohet në zona arkeologjike “A” dhe zona arkeologjike “B”.

Neni 3

Ndërhyrjet në zonën arkeologjike “A” të qytetit të Vlorës

Në zonën arkeologjike “A” të qytetit të Vlorës lejohet:

1. Restaurimi dhe konservimi i monumenteve dhe strukturave arkeologjike, kryerja e sondazheve arkeologjike me synim studimin e plotë të zonës, mbi bazën e projekteve të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.

2. Rikonstruksioni i rrugëve dhe të gjitha punimet në rrjetin inxhinierik ujësjellës-kanalizime, ndriçim, telefoni, mbi bazën e projekteve të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.

3. Vendosja e konstruksioneve të lehta (dru, xham, plastikë, metal) gjatë aktiviteteve kulturore me lartësi maksimale 3 m, të cilat duhen realizuar larg mureve dhe strukturave të tjera të dallueshme apo të supozuara. Konstruksionet vendosen dhe përdoren nga institucionet shtetërore të specializuara, duhet të jenë të lëvizshme (të çmontueshme) dhe që në asnjë rast nuk duhet të dëmtojnë nëntokën dhe peizazhin, në funksion të ruajtjes, ekspozimit, informimit publik dhe nevojave të tjera që lidhen me veprimtarinë arkeologjike në veçanti dhe trashëgiminë kulturore në përgjithësi. Projekti miratohet nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve dhe për çdo rast duhet të përcaktojë saktësisht qëllimin, kohëzgjatjen, vendndodhjen e strukturës brenda zonës, si dhe planprojektin e saj.

Neni 4

Ndërhyrjet në zonën arkeologjike “B” të qytetit të Vlorës

Në zonën arkeologjike “B” të qytetit të Vlorës lejohen:

1. Ndërtimet e reja pas miratimit me shkrim nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë të kërkesave të subjekteve të interesuara.

2. Ndërtimet lejohen vetëm pas kryerjes paraprake nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik të vëzhgimit intensiv, sondazheve arkeologjike apo formave të tjera të testimit në varësi të potencialit që përfaqëson zona me miratim të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë.

3. Format e testimit përcaktohen nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, por kryesisht janë sondazhe që nuk cenojnë shtresat në rast të vijimit të gërmimit arkeologjik, studime gjeofizike, regjistrim digjital i terrenit, vëzhgim intensiv arkeologjik etj.

4. Në rastet kur gjatë zbatimit të projektit ndërtimor zbulohen gjetje të rëndësishme të veçantë, projekti duhet të rishikohet. Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë miraton ndryshimet në projekt duke marrë në konsideratë konservimin, ruajtjen, si dhe bërjen e tyre të vizitueshme. Vetëm pas miratimit të ndryshimeve lejohet vazhdimi i punimeve.

Neni 5

Procedurat që ndiqen për ndërhyrjet ndërtimore në zonën arkeologjike “B”

1. Për çdo ndërhyrje që prek nëntokën, në zonat arkeologjike “B”, subjekti ndërtues i interesuar vë në dijeni Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare, përgjegjëse për qytetin e Vlorës, dhe paraqet pranë Sekretarisë Teknike të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë dokumentacionin si më poshtë:

- Fotokopje e noterizuar e lejes së sheshit të ndërtimit nga organet kompetente, sipas ligjit nr.10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”;

- Fotokopje e noterizuar e vendimit të gjykatës ose regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

- Prokurë për personin e autorizuar për nënshkrimin e kontratës, nëse nuk është administratori i subjektit.

2. Pas shqyrtimit dhe miratimit të kërkesës së subjektit nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë, Agjencia e Shërbimit Arkeologjik nënshkruan një kontratë me subjektin, për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve.

Neni 6

1. Për ndërhyrjet pa leje brenda zonës arkeologjike “B”, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, përgjegjëse për qytetin e Vlorës, pezullon menjëherë subjektin dhe njofton Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, Institutin e Monumenteve të Kulturës dhe strukturën përgjegjëse për trashëgiminë kulturore në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

2. Në rast se subjekti nuk pezullon veprimet brenda 24 orëve, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare përgjegjëse i drejtohet menjëherë Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor dhe Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar për pezullimin e ndërtimit deri në prishjen e tij.

3. Në rast të shkeljeve të procedurave nga subjektet ndërtimore, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë për subjektin, si dhe për drejtuesin teknik përkatës, nuk merr në shqyrtim për një periudhë 3-vjeçare asnjë kërkesë për ndërtim në zona arkeologjike “B” në të gjithë territorin e vendit, apo në zona të tjera, ku sipas ligjit kërkohet miratimi i Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë.

Neni 7

Gjetjet arkeologjike

1. Klasifikohen si gjetje arkeologjike, objektet e luajtshme dhe të paluajtshme në kontekstet arkeologjike, struktura murale (varre monumentale, pjesë mozaiku të shtrirë në një sipërfaqe mbi 4 m², afreske, ndërtime inxhinierike, pjesë arkitekturore që lidhen me strukturat murale dhe banesa, tempuj e godina të tjera shërbimesh).

2. Në rast gjetjesh të rëndësishme të paluajtshme, punimet e nisura pezullohen menjëherë nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik. Brenda afatit prej 10 ditësh nga ndërprerja e punimeve, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë vendos për veprimet e mëtejshme. Veprimet e mëtejshme, në lidhje me vazhdimin e ndërtimit, do të ndërmerren nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik në cilësinë e Sekretarisë Teknike të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë, jo më vonë se 30 ditë nga ndërprerja e punimeve. Nëse gjetjet janë me vlera të rëndësishme, punimet e filluara të ndërpriten përfundimisht. Vendimi në këtë rast merret nga organi që ka autorizuar fillimin e punimeve, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë.

3. Në rast se Agjencia e Shërbimit Arkeologjik i propozon ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore shpalljen monument kulture të një objekti të paluajtshëm, Instituti i Monumenteve të Kulturës bën studimin e zonës mbrojtëse të saj brenda 30 ditëve nga zbardhja e vendimit për shpalljen monument kulture.

4. Shpenzimet për kryerjen e hulumtimeve të nevojshme, përgatitjen e dokumentacionit, si dhe për ndryshimet e mundshme të projektit kur vendoset që gjetjet të mbrohen në vend (*in situ*), të gjitha shpenzimet për to, si dhe shpenzimet për kërkimet shkencore, veprimtaritë e nevojshme restauruese ose konservuese mbulohen 100% nga investitori.

5. Në rast të gjetjeve arkeologjike të rëndësishme, kur Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë vendos ndërprerjen përfundimtare të punimeve, investitori shpronësohet në bazë të kuadrit ligjor në fuqi.

Neni 8

Gërmimet e shpëtimit

1. Në rast gjetjesh arkeologjike, zhvillohet gërmim i shpëtimit. Gërmimi i shpëtimit kryhet nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare, përgjegjëse për qytetin e Vlorës, ose nga subjekte private me leje të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë, nën mbikëqyrjen e Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.

2. Në rast se gjatë kryerjes së gërmimit të shpëtimit gjykohet e nevojshme asistencë shkencore dhe teknike në terren e specialistëve të Institutit të Arkeologjisë, kërkohet zyrtarisht pjesëmarrja e tyre në gërmim.

3. Nëse pas kryerjes së gërmimit të shpëtimit zbulohen gjetje të rëndësishme të veçantë (strukturë etj.), Agjencia e Shërbimit Arkeologjik pezullon gërmimin dhe propozon në Këshillin Kombëtar të Arkeologjisë ndryshimet në projekt, me synim mbrojtjen dhe bërjen të vizitueshme të këtyre vlerave.

4. Vazhdimi i punimeve ndërtimore lejohet mbas verifikimit nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik të përmbushjes së kriterëve të vendosura nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë për zbatimin korrekt të projektit të mbrojtjes dhe vizitueshmërisë.

5. Në përfundim të çdo gjurmimi shpëtimi përgatitet një relacion i plotë, i cili i paraqitet Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë për miratim brenda 30 ditëve. Pas shqyrtimit dhe miratimit, një kopje e relacionit të plotë depozitohet edhe pranë Institutit të Arkeologjisë.

6. Në rastin kur gjurmimi i shpëtitimit kryhet nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, relacioni firmoset nga drejtuesi i grupit dhe nga anëtarët e tij, si dhe konfirmohet nga drejtori i Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.

7. Në rastin kur gjurmimi i shpëtitimit kryhet nga një subjekt privat, relacioni firmoset/konfirmohet nga drejtuesi i projektit të subjektit, minimumi 2 arkeologë të këtij subjekti dhe nga specialisti i autorizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, i cili ka qenë prezent gjatë gjurmimit.

Neni 9

1. Vëzhgimi intensiv sipërfaqësor (*survey*) dhe sondazhet arkeologjike kryhen nga specialistë të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik, në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare, përgjegjëse për qytetin e Vlorës. Në çdo projekt të ndërmarrë nga subjektet, është e detyrueshme pjesëmarrja e një përfaqësuesi të autorizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik.

2. Kur subjekti privat kryen shkelje duke mos respektuar legjislacionin në fuqi, Agjencia e Shërbimit Arkeologjik pezullon gjurmimin dhe relaton menjëherë në Këshillin Kombëtar të Arkeologjisë, duke propozuar edhe masat përkatëse. Agjencia e Shërbimit Arkeologjik vulos kantierin dhe e monitoron atë, në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare, përgjegjëse për qytetin e Vlorës.

3. Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë pasi shqyrton rastin vendos:

a) Lënien në fuqi të vendimit të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik për pezullimin e punimeve;

b) Shfuqizimin e vendimit për pezullim dhe lejimin e vijimit të punimeve.

4. Në rastet kur subjekti privat nuk e kryen gjurmimin sipas kuadrit ligjor në fuqi, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë i delegon Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik të vazhdojë gjurmimet.

5. Vendimi i Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë është i formës së prerë.

Neni 10

Vendosja e tabelave prezantuese dhe paneleve shpjeguese

1. Në zonën arkeologjike “A” dhe “B” vendosja e tabelave prezantuese dhe paneleve shpjeguese për monumente të veçanta, rrënoja apo hapësira me potencial arkeologjik, bëhet vetëm në vendet e përcaktuara sipas rastit nga Instituti i Monumenteve të Kulturës dhe Agjencia e Shërbimeve Arkeologjike dhe zbatohet nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, përgjegjëse për qytetin e Vlorës.

2. Në asnjë rast tabelat prezantuese dhe panelet shpjeguese nuk duhet të dëmtojnë apo konkurrojnë monumentin.

3. Vendosja e tabelave të sinjalistikës rrugore/turistike pranë monumenteve dhe zonave të mbrojtura rreth tyre bëhet në mbikëqyrjen e Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare, përgjegjëse për Vlorën.

4. Për çdo veprimtari me karakter kulturor në zonat arkeologjike “A” dhe “B”, vendosja e tabelave dhe e materialeve publicitare lejohet në raste të veçanta festivo-kulturore dhe ka karakter të përkohshëm. Vendosja e tyre ekzekutohet vetëm në zbatim të urdhrit të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe nën mbikëqyrjen e Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare, përgjegjëse për Vlorën.

5. Është e ndaluar vendosja e posterave publicitare (jokulturorë) dhe politikë, si dhe dëmtimet e tjera të monumenteve dhe rrënojave arkeologjike (vizatimi, shkrimi mbi strukturat e paluajtshme).

Neni 11

Kjo rregullore shoqërohet me hartën e zonifikimit, e cila rishikohet periodikisht, bazuar në të dhënat e reja arkeologjike, si dhe nevojën për mbrojtjen e monumenteve.

Neni 12

Në studimet urbanistike për qytetin e Vlorës duhet të merret parasysh zonifikimi arkeologjik i qytetit të Vlorës dhe përcaktimet e kësaj rregulloreje.

Studimet urbanistike të miratuara që janë në fazën e zbatimit, si dhe rregulloret përkatëse të tyre, duhet të rishikohen, me qëllim që të zbatohet zonifikimi arkeologjik i qytetit të Vlorës dhe përcaktimet e rregullores përkatëse.

Neni 13

Shkelja e kësaj rregulloreje ngarkon me përgjegjësi sipas dispozitave të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, i ndryshuar, dhe Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

VENDIM

Nr.730, datë 8.9.2010

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2010, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË KURIMIT, TË ZNJ.NAIDA KAPO, NË ITALI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2010, zëri “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi prej 1 100 000 (një milion e njëqind mijë) lekësh, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit të znj. Naida Kapo, në Itali.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.
3. Pagesat të bëhen kundrejt paraqitjes së faturave origjinale.
4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.732, datë 1.9.2010

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS SHËNGJERGJ TË QARKUT TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të komunës Shëngjergj të qarkut të Tiranës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrative të komunës Shëngjergj të qarkut të Tiranës, miratuar me vendimin nr.1054, datë 22.4.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Shëngjergj të qarkut të Tiranës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Shëngjergj për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Shëngjergj

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1219-1225	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
1226-1228	Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore, historike e sportive.	Në pronësi
1229	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative.	Në pronësi
1230,1231	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
1233-1243	Varreza publike	Në pronësi
1244-1267,1342,1343	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike).	Në pronësi
1280,1281,1284,1285, 1288,1290,1291,1293, 1294,1297-1299, 1301-1303	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
1282,1283,1286,1287, 1289,1292,1295,1296, 1300,1304,1305	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive).	Në pronësi

VENDIM
Nr.733, datë 1.9.2010

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.591, DATË 23.7.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR DISIPLINIMIN E PËRDORIMIT TË FONDEVE BUXHETORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 21.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të nenit 10 të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fund të shkronjës “dh” të pikës 1 të vendimit nr.591 datë 23.7.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të shtohet një paragraf me këtë përmbajtje: “Përfundimisht, lejohen Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve (DPUK), si autoritete kontraktore, të vijojnë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimeve, përkatësisht, për objektet “Riparimi i shtresave rrugore, në aksin Tiranë-Dajt, segmenti pranë antenave” dhe “Linja e transferimit të Kafarajt.”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës – Kanalizimeve (DPUK), dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.735, datë 1.9.2010

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË
KOMUNËS TERPAN TË QARKUT TË BERATIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Terpan të qarkut të Beratit, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 115 (njëqind e pesëmbëdhjetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 798 (shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Terpan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1	Prona që përdoren në fushën administrative.	Në pronësi
2-13,794,795,796	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
14-15,797	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
16-25	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
26-40	Varreza publike	Në pronësi
41-60	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
61-74	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji.	Në përdorim
100-133,135-137,140-142,144-146,148-151,153-163	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
134,138,139,143,147,152	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive).	Në pronësi

VENDIM
Nr.736, datë 8.9.2010

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1293, DATË 29.12.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KRYETARIT DHE EMËRIMIN E ANËTARËVE, PËRFAQËSUES TË PUSHTETIT QENDROR, NË KËSHILLIN DREJTUES TË FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.10130, datë 11.5.2009 “Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 1 të vendimit nr.1293, datë 29.12.2009 të Këshillit të Ministrave, emërtimi “...Ministrit të Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin ...” të zëvendësohet me “...Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit...”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.738, datë 8.9.2010

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE TË PROCEDURAVE TË SHITJES SË TROJEVE NË PËRDORIM, SIPËRFAQE TË DOMOSDOSHME DHE SHITESË FUNKSIONALE TË NDËRMARRJEVE, SHOQËRIVE APO TË OBJEKTEVE SHTETËRORE, TË VEÇUARA, TË PRIVATIZUARA DHE TË NDËRTESAVE TË NDËRTUARA NË BAZË TË LEJEVE TË NDËRTIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9967, datë 24.7.2008 “Për miratimin e aktit normativ nr.4, datë 9.7.2008 “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim të shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore, të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros të këtyre ndërmarrjeve”, të ligjit nr.10270, datë 22.4.2010 “Për të drejtën e privatizimit të truallit shtetëror në përdorim dhe për taksën mbi të drejtën e përdorimit të tij” dhe të neneve 3 e 4 të ligjit nr.7980, datë 27.9.1995 “Për shitblerjen e trojeve”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. PROCEDURAT E SHITJES SË TRUALLIT NË PËRDORIM, SIPËRFAQE TË DOMOSDOSHME, TË NDËRMARRJEVE DHE OBJEKTEVE SHTETËRORE, TË PRIVATIZUARA DHE TË NDËRTESAVE TË NDËRTUARA NË BAZË TË LEJEVE TË NDËRTIMIT

1. Shitja e truallit të pashitur të ndërmarrjeve dhe objekteve shtetërore, të privatizuara, nga ish-Agjencia Kombëtare e Privatizimit, degët e saj në rrethe, nga ish-Agjencia Qendrore e Ristrukturimit dhe Privatizimit të Ndërmarrjeve Bujqësore, me degët e saj në rrethe, nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, të bëhet në përputhje me këtë vendim, sipas genplanit, që i bashkëlidhet dosjes së privatizimit.

2. Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, kryen edhe shitjen e trojeve të ndërmarrjeve e objekteve të tjera shtetërore, të privatizuara para krijimit të këtyre agjencive, si dhe të truallit të ndërtesave, të ndërtuara në bazë të lejeve të ndërtimit, të lëshuara nga ish-komitetet pluraliste të këshillave, në periudhën e funksionimit të tyre, sipas genplaneve në kohën e lëshimit të lejes së ndërtimit.

3. Personi fizik apo juridik, privat, i cili do të blejë truallin e ndërmarrjes ose të objekteve që kanë privatizuar më parë apo ndërtuar sipas lejeve të ndërtimit, në përputhje me përcaktimet e këtij vendimi, duhet të paraqesë në dy kopje, në Ministrinë e Financave, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, dokumentet e mëposhtme:

a) Kërkesën me shkrim për blerje të truallit;

b) Vërtetimin hipotekor, certifikatën e pronësisë të noterizuar, nëse ka, kartelën e pasurisë etj., për objektin, të lëshuar nga zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, si dhe hartën treguese të pasurive të paluajtshme në zonën përkatëse, nëse është e përditësuar jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e paraqitjes së kërkesës;

c) Fotokopjen e noterizuar të kontratës së shitjes së objektit apo të ndërmarrjes, lëshuar nga ish-Agjencia Kombëtare e Privatizimit, ish-Agjencia Qendrore e Ristrukturimit dhe Privatizimit të Ndërmarrjeve Bujqësore, Ministria e Financave, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike dhe nga ndërmarrjet përkatëse, përpara krijimit të agjencive, si dhe fotokopjen e noterizuar të genplanit apo të planimetrisë së objektit (në çastin e privatizimit);

ç) Kopjen e noterizuar të lejes së ndërtimit, genplanin e miratuar sipas lejes së ndërtimit, për rastet e objekteve të ndërtuara në bazë të lejeve të ndërtimit, të lëshuara nga komitetet pluraliste të këshillave të rretheve, në periudhën e funksionimit të tyre;

d) Deklaratën notoriale në 2 (dy) kopje origjinale, që vërteton se nuk ka proces gjyqësor për objektin dhe truallin përkatës.

4. Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, u kërkon Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të konfirmojë statusin e truallit, çmimin përkatës të shitjes, të përcaktuar në hartën e çmimeve, në zbatim të vendimit nr.183, datë 23.4.2005 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për miratimin e metodikës për vlerësimin e pronës së paluajtshme që kompensohet dhe asaj që do të shërbejë për kompensim” dhe hartën treguese, me të dhënat e nevojshme gjeografike për zonën përkatëse, nëse ato janë të përditësuara, brenda afateve të mëposhtme:

a) Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së përcaktuar në shkronjën “a” të pikës 3 të këtij vendimi, për rastet kur privatizimet janë kryer nga ish-Agjencia Kombëtare e Privatizimit dhe degët e saj në rrethe, nëse dosja e privatizimit gjendet e rregullt;

b) Brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e mbërritjes, përkatësisht, të dokumentacionit të privatizimit, nga drejtoritë rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit, për privatizimet e kryera nga ish-Agjencia Qendrore e Ristrukturimit të Ndërmarrjeve Bujqësore, dhe të dokumentacionit të dhënies së lejes së ndërtimit nga organet e pushtetit vendor, ku janë të depozituara dokumentacionet përkatëse për këto objekte.

5. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave i kthen përgjigje Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës. Ndërsa zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, i përcjellin kësaj drejtorie hartën treguese përkatëse, me të dhënat e nevojshme gjeografike dhe statusin e truallit.

6. Në rastet kur konfirmohet se trualli i objekteve apo ndërmarrjeve të shitura ka pronarë, të njohur me vendim të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, apo ka pronar shtetin, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, kryen shitjen e truallit dhe lidhjen e kontratës.

7. Organet e qeverisjes vendore apo çdo organ tjetër shtetëror, me të cilët subjektet kanë lidhur kontratë qiraje për truallin në përdorim, brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, i përcjellin kësaj drejtorie vërtetimin, nëse subjekti kërkues ka paguar qiranë e truallit.

8. Vlera e qirasë së tokës, e arkëtuar pranë organeve të qeverisjes vendore apo organeve të tjera shtetërore, me të cilat subjektet kanë lidhur kontratë qiraje, ndahet, si më poshtë vijon:

- 70% Buxheti i Shtetit;

- 30% organi i qeverisjes vendore apo organi shtetëror përkatës.

9. Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, pas marrjes së dokumentacionit të nevojshëm nga organet e qeverisjes vendore, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme apo organet e tjera shtetërore, njofton kërkuesin për t’u paraqitur pranë këtij institucioni, ku do të marrë informacion për vlerën e truallit që ai kërkon të privatizojë, si dhe për marrjen e autorizimit për pagesën e vlerës së truallit. PAGESA kryhet vetëm me lekë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e lëshimit të autorizimit, përveç rasteve që parashikohen në ligjin nr.10 270, datë 22.4.2010 “Për të drejtën e privatizimit të truallit shtetëror në përdorim dhe për taksën mbi të drejtën e përdorimit të tij”.

Të ardhurat e arkëtuara nga shitja e truallit kalojnë 100% për Buxhetin e Shtetit.

10. PAGESA e qirasë së truallit në përdorim, sipërfaqe të domosdoshme për subjektet, që e kanë paguar dhe që duhet ta paguajnë rregullisht atë deri në datën 7.6.2010 për objektet apo ndërmarrjet e privatizuara, bëhet në zbatim të akteve ligjore a nënligjore, sipas periudhave përkatëse dhe kontratave të qirasë të lidhura për këtë qëllim, e cila është me një çmim vjetor sa 1/10 e vlerës së truallit.

11. Kur ish-pronari i truallit është bërë pronar i objektit duke përdorur të drejtën e parablerjes sipas pikës 2 të kreut III të vendimit nr.428, datë 9.6.2010 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes”, trualli kalon në favor të tij pa shpërblim. Ndërsa kur ish-pronarët e truallit nuk kanë përfutur objekt në trojet, ish-pronë e tyre, u lind e drejta e kompensimit fizik.

12. Kur objekti është me dy a më shumë kate dhe në të ka disa pronarë, atëherë shitja e truallit të bëhet në bashkëpronësi, sipas pjesëve takuese.

13. Në rastet kur mungon dosja e privatizimit të objektit apo genplani, akti i dorëzimit etj., për arsye objektive, pranë Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, kopja e dosjes së vlerësimit (privatizimit apo dokumentacionit që i mungon dosjes) të objektit ose ndërmarrjes, dokumentacioni i dhënies së lejes së ndërtimit, genplanit të miratuar, sipas lejes së ndërtimit, për rastet e objekteve të ndërtuara në bazë të lejeve të ndërtimit, të lëshuara nga komitetet pluraliste të këshillave, në periudhën e funksionimit të tyre, ky dokumentacion të kërkohet në degët e shoqërive publike, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, në juridiksionin e të cilave ndodhet objekti, Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave ose Arkivin Shtetëror Vendor dhe arkivat noterialë. Në rast se, edhe në organet e sipërpërmendura nuk gjendet dosja e vlerësimit (privatizimit apo dokumentacionit që i mungon dosjes) të objektit, atëherë Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, pranon dosjen e privatizimit që ka paraqitur blerësi i objektit apo ndërmarrjes (dosjen e dhënies së lejes së ndërtimit me genplanin përkatës, kontratën e shitjes, aktin e dorëzimit, autorizimin për kalim pronësie, genplanin apo planimetrinë etj.), të njohura këto me vendim gjykate të formës së prerë.

14. Subjektet, të cilat kanë bërë kërkesën për privatizimin e truallit në përdorim, sipërfaqe të domosdoshme, përpara datës 7.6.2010, të vazhdojnë procedurën për privatizimin e tij, sipas procedurave të përcaktuara në këtë vendim, por me kusht që të përsëritet kërkesa vetëm për mënyrën e realizimit të pagesës së vlerës së truallit, brenda datës 7.6.2011.

15. Ky vendim nuk zbatohet për procedurat e vlerësimit të truallit të objekteve apo ndërmarrjeve, dokumentacioni i të cilave është në Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave dhe ndodhen në fazën kur është konfirmuar çmimi i truallit nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe ka përfunduar pagesa për vlerën e plotë të tyre.

II. PROCEDURAT PËR SHITJEN E TROJEVE SHITESË, FUNKSIONALE, TË NDËRMARRJEVE, SHOQËRIVE APO TË OBJEKTEVE TË VEÇUARA SHTETËRORE, TË PRIVATIZUARA, PËR LLOGARI TË FONDIT TË KOMPENSIMIT FINANCIAR

1. Me “Truall shtesë funksional” për ndërmarrjet, objektet e veçuara shtetërore apo shoqëritë me kapital të përbashkët dhe shoqëritë aksionare të privatizuara, sipas këtij vendimi, nënkuptohet truall që ndodhet brenda ose jashtë vijave kufizuese të territoreve të njëjësive të qeverisjes vendore, që kërkohet nga pronarët e ndërmarrjeve, të objekteve apo shoqërive me kapital të përbashkët dhe të shoqërive aksionare të privatizuara prej tyre, për zgjerim, shërbime apo ristrukturim të veprimtarisë dhe që në bazë të rregullave urbanistike, të konfirmuara nga zyrat e urbanistikës në prefekturën e qarkut përkatës, nuk mund të përdoret nga një person tjetër.

2. Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, ngarkohet të kryejë procedurën e shitjes së trojeve shtesë funksionale, të ndërmarrjeve shtetërore, të objekteve të veçuara, të shoqërive me kapital të përbashkët dhe të shoqërive aksionare të privatizuara nga ish-Agjencia Kombëtare e Privatizimit, ish-Agjencia Qendrore e Ristrukturimit të Ndërmarrjeve Bujqësore dhe Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave (të cilat kanë privatizuar sipërfaqen e truallit, sipërfaqe e domosdoshme), për llogari të fondit të kompensimit financiar, të sipërfaqeve të tokave që plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) të jenë në pronësi të shtetit dhe të patransferuara në inventarin e njëjësive të qeverisjes vendore, në bazë të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar;

b) të jenë të përfshira brenda një pasurie të paluajtshme, në pronësi të kërkuesit apo edhe të personave të tjerë, të përfituar nga privatizimi, që rrethon apo lidh dy a më shumë pasuri të paluajtshme dhe në këtë rast, tjetërsimi të bëhet në bashkëpronësi.

3. Sipërfaqet e truallit shtesë funksional për ndërmarrjet, objektet e veçuara shtetërore apo shoqëritë me kapital të përbashkët dhe shoqëritë aksionare, të privatizuara, të verifikohen dhe të konfirmohen nga një komision, i cili ka në përbërje përfaqësues nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, nga prefektura e qarkut përkatës (punonjësi i zyrës së

urbanistikës) dhe nga zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Sipërfaqja e trullit shtesë që përfitohet nga subjektet kërkuese duhet të jetë në përputhje me masën e përcaktuar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, si dhe e verifikuar nga komisioni, sipas pikës 3 të kreut II të këtij vendimi. Bëjnë përjashtim nga sipërfaqet e përcaktuara në këtë tabelë, rastet e parashikuara në shkronjën “b” të pikës 2 të këtij kreu.

4. Kërkesa për kryerjen e procedurave të shitjes së trojeve shtesë funksionale në favor të subjekteve, që kanë privatizuar ndërmarrje, objekte të veçuara apo shoqëri me kapital të përbashkët dhe shoqëri aksionare, për llogari të fondit të kompensimit financiar, të përcaktuar në këtë vendim, paraqitet nga kërkuesit, pranë Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, së bashku me dokumentet e përcaktuara në pikën 4 të kreut I të këtij vendimi, si dhe me genplanin e sipërfaqes së kërkuar për t’u blerë, të përgatitur nga ekspertë të licencuar.

5. Kërkesa dhe dokumentacioni shqyrtohen nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, sipas kësaj procedure:

a) Fillimisht kjo drejtori u dërgon për verifikim, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e mbërritjes së kërkesës, Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronës dhe Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, genplanin e sipërfaqes në çastin e privatizimit, genplanin e sipërfaqes së kërkuar për t’u blerë dhe hartën treguese.

b) Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronës dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes në dorëzim të kërkesës nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, kryejnë verifikimin e hollësishëm të këtij dokumentacioni, për të vërtetuar se trulli, që kërkohet të shitet, nuk është i kthyer me vendim të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe është në pronësi të shtetit.

c) Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronës i dërgon informacion Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, për çmimin e përlllogaritur të sipërfaqes së trullit që do të shitet, sipas hartës së vlerës, të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

ç) Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, u kërkon organeve, që kanë lëshuar dokumentet, të konfirmojnë vërtetësinë e tyre.

d) Komisioni i ngritur sipas pikës 3 të kreut II të këtij vendimi, pas verifikimit të sipërfaqes së trullit shtesë funksional, të kërkuar, mban procesverbal për çdo rast dhe nënshkruan genplanin, që i përket sipërfaqes së trullit shtesë.

6. Shitja e trullit shtesë funksional kryhet vetëm me lekë dhe të ardhurat e realizuara nga kjo shitje i kalojnë Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronës, për llogari të kompensimit financiar të ish-pronarëve.

7. Kalimi i pronësisë së sipërfaqes së trullit shtesë funksional bëhet nëpërmjet kontratës së shitjes, e cila nënshkruhet nga drejtori i Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave dhe blerësi, pas kryerjes së pagesës së plotë të vlerës së trullit, të përcaktuar në autorizimin për kalimin e pronësisë, të lëshuar nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave. Autorizimi është pjesë përbërëse e kontratës së shitjes.

8. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

9. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.98, datë 27.1.2009 “Për kriteret dhe procedurat e shitjes së trojeve të ndërmarrjeve shtetërore apo të objekteve shtetërore, të veçuara, të privatizuara”, dhe nr.648, datë 11.6.2009 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të shitjes së trojeve shtesë funksionale të ndërmarrjeve apo të objekteve shtetërore, të veçuara, të privatizuara, për llogari të fondit të kompensimit financiar”, si dhe udhëzimet në zbatim të tyre, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**SASIA E SIPËRFAQES SHITESË QË MUND TË PËRFTOJNË SUBJEKTET PËR OBJEKTE
TË VEÇUARA TË PRIVATIZUARA**

Sipërfaqja e objekteve të privatizuara (nën objekt + funksionale)	Shtesa e sipërfaqeve
Sipërfaqet deri në 50 m ²	Deri në 150 m ²
Sipërfaqet nga 51 m ² deri në 100 m ²	Deri në 200 m ²
Sipërfaqet nga 101 m ² -500 m ²	Deri në 400 m ²
Sipërfaqet nga 501 m ² -1000 m ²	Deri në 600 m ²
Sipërfaqet nga 1001 m ² -5000 m ²	Deri në 2500 m ²
Sipërfaqet mbi 5000 m ²	Deri në 5000 m ²

UDHËZIM

Nr.3, datë 20.8.2010

**PËR STANDARDIZIMIN E FORMATIT TË AKTIT TË MIRATIMIT TË LEJEVE DHE
AUTORIZIMEVE MJEDISORE**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 39 pika 1 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Unifikimin dhe standardizimin e aktit të miratimit të lejeve dhe autorizimeve mjedisore në përputhje me ndikimet konkrete në mjedis, si dhe kërkesat e ndryshimet e legjislacionit mjedisor të miratuar pas lëshimit të lejeve/autorizimeve mjedisore ekzistuese në përputhje me specifikat e çdo veprimtarie.

2. Aktet e miratimit të lejeve mjedisore, përfshi dhe të autorizimeve mjedisore, që lëshohen për veprimtaritë me ndikim në mjedis sipas përcaktimeve në ligj, do të hartohen sipas formatit bashkëlidhur në shtojcën I dhe II të këtij udhëzimi.

3. Kërkesave të këtij udhëzimi u nënshtrohen edhe lejet/autorizimet mjedisore të lëshuara para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi.

4. Në kuadër të zbatimit të këtij udhëzimi, agjencitë rajonale të mjedisit identifikojnë të gjitha subjektet/veprimtaritë e pajisura me leje mjedisore në qarkun përkatës dhe dërgojnë informacion pranë Drejtorisë së Mbrojtjes së Mjedisit të shoqëruar edhe me informacion për mënyrën e zbatimit të kushteve të lejeve mjedisore nga çdo subjekt.

5. Në kuadër të zbatimit të këtij udhëzimi, agjencitë rajonale të mjedisit dhe Drejtoria e Mbrojtjes së Mjedisit udhëzojnë subjektet e pajisura me leje dhe autorizim mjedisor, të lëshuara para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, që të paraqesin pranë Qendrës Kombëtare të Licencimit informacionin e mëposhtëm për t'u ripajisur me aktin e miratimit të lejes/autorizimit:

a) Të dhëna të mbajtësit të lejes, emërtimi, adresa, personi i kontaktit dhe mënyra e kontaktit (telefon, e-mail etj.);

b) Një relacion të shkurtër për veprimtarinë e pajisur me leje mjedisore dhe aktivitetet që ajo kryen;

c) Fotokopjen e lejes/autorizimit mjedisor;

d) Një informacion për masat e marra për zbatimin e kushteve të lejes/autorizimit mjedisor;

e) Në rast se në lejen/autorizimin mjedisor kërkohet rehabilitim mjedisor, të paraqitet informacion për punimet rehabilituese që janë realizuar;

f) Për veprimtaritë me shkarkime në mjedis, të paraqiten rezultatet e vetëmonitorimit të shkarkimeve në mjedis për një periudhë pararendëse 1-vjeçare që nga data e paraqitjes së kërkesës pranë QKL-së, të shoqëruar me emrin e subjektit që ka kryer matjen, mënyrën e marrjes së mostrës së analizuar, instrumentin matës dhe mënyrën/metodën e analizimit të mostrës;

6. Drejtoria e Mbrojtjes së Mjedisit, pasi vlerëson informacionin e paraqitur nga subjektet sipas pikës 5 më sipër, informon Ministrin për zbatimin e kushteve të lejes mjedisore nga çdo subjekt.

7. Kur informacioni i paraqitur nga subjekti është i plotë, atëherë Drejtoria e Mbrojtjes së Mjedisit përgatit aktin e miratimit të lejes mjedisore dhe e përcjell në mënyrë elektronike pranë Qendrës Kombëtare të Licencimit.

8. Për autorizimet mjedisore, procedurat e pikës 6 dhe 8 kryhen nga agjencitë rajonale të mjedisit, të cilat koordinojnë punën e tyre me Drejtorinë e Mbrojtjes së Mjedisit.

9. Për procedurat e mësipërme subjektet që posedojnë leje/autorizim mjedisor nuk paguajnë tarifë shërbimi sipas përcaktimeve në udhëzimin nr.5, datë 28.12.2007 “Për tarifën e shërbimit për leje mjedisore”.

10. Pëlqimet mjedisore nuk do t’i nënshtrohen zbatimit të këtij udhëzimi.

11. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Drejtoria e Mbrojtjes së Mjedisit, si dhe agjencitë rajonale të mjedisit.

12. Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, shfuqizohet shtojca III e udhëzimit nr.2, datë 21.5.2007 “Për miratimin e listës së veprimtarive me ndikim në mjedis, mënyrën e aplikimit dhe rregullat e procedurat e dhënies së autorizimit dhe pëlqimit mjedisor nga agjencitë rajonale të mjedisit”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE
DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Fatmir Mediu



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Drejtoria e Përgjithshme e Politikave
Drejtoria e Mbrojtjes së Mjedisit
Sektori i vlerësimit të ndikimit në mjedis

Nr. ___ Prot. Rruga e Durrësit, nr.27 Tiranë, Tel.: 04 224 572 Fax. 0 4 270 627 – www.moe.gov.al Tiranë, më ____ . ____

Nr. identifikues _____ Vendimi nr. ____ i komisionit të lejeve
Në rast se është leje ekzistuese nr.i vendimit dhe data
e miratimit të lejes që do të formatohet _____ . _____

Akt miratimi
LEJE MJEDISORE

Për veprimtari që kanë ndikim ndaj mjedisit

Në mbështetje të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe ndryshimeve të tij, subjektit “” i jepet leja mjedisore për veprimtarinë:

- 1. Përshkrim të veprimtarisë së lejuar, përfshirë emërtimin, natyrën, vendndodhjen e saj, sipërfaqen dhe kapacitetet prodhuese etj.**
- 2. Të dhëna të mbajtësit të lejes, emërtimi, adresa, emrin e personit të kontaktit dhe mënyrën e kontaktit (telefon, e-mail etj.)**
- 3. Kushtet e lejes:**
 - 3.1- Gjatë fazës së ndërtimit/përgatitjes;
 - 3.2- Gjatë fazës së funksionimit/shfrytëzimit;
 - 3.3- Gjatë fazës së rehabilitimit (për karriera etj.).
- 4. Shkarkimet në mjedis dhe vlerat kufi të lejuara të shkarkimeve:**
 - 4.1 -Shkarkimet në ajër;
 - 4.2- Shkarkimet në ujë;
 - 4.3 -Shkarkimet në tokë.
- 4. Detyrime të vetëmonitorimit e ndikimeve në mjedis:**

Kërkesat për realizimin e vetëmonitorimit të shkarkimeve në mjedis, duke përfshirë treguesit që do të monitorohen, stacionet e marrjes së monstrave dhe frekuencën e matjes së tyre, metodën e matjes apo të llogaritjes, regjistrimit të të dhënave.
- 5. Raportimi i të dhënave:**

Kërkesat për raportimin e të dhënave në agjencitë rajonale të mjedisit dhe Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave lidhur me masat e marra për zbatimin e kushteve të lejes mjedisore, si dhe raportimin e rezultateve të vetëmonitorimit të shkarkimeve në mjedis.
- 6. Vlefshmëria e lejes së mjedisit.**
- 7. Referenca të ligjeve që duhet të zbatohen në kuadër të veprimtarisë.**
- 8. Sanksionet e mundshme në rast të shkeljes së kushteve të lejes mjedisore.**
- 9. Vlera e tarifës së shërbimit të lejes mjedisore.**

NËNSHKRIMI

(_____)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
AGJENCIA RAJONALE E MJEDISIT E QARKUT _____

Nr. ___ Prot.

Data, më ____ . ____

Nr. identifikues

Nr. i vendimit

Në rast se është ekzistues nr. i vendimit dhe data e miratimit të autorizimit që do të formatohet ____ . ____

Akt miratimi

AUTORIZIM MJEDISOR

Në mbështetje të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, miratohet autorizimi mjedisor:

Veprimtarisë.....

Subjektit.....

Vendndodhja.....

Veprimtaria do të zhvillohet me këto kushte dhe kërkesa:

1. Detajimi i kushteve për respektimin e normave të shkarkimeve në çdo nyje shkarkuese të veprimtarisë dhe në total, duke i cituar normat e përkohshme apo të përhershme të shkarkimeve.
2. Kërkesat për realizimin e vetëmonitorimeve të shkarkimeve në mjedis të veprimtarisë dhe regjistrimit të të dhënave.
3. Detyrimi për të dorëzuar të dhënat e vetëmonitorimit në agjencitë rajonale të mjedisit.
4. Përcaktimi i masave dhe afatet për rehabilitimin e mjedisit të dëmtuar apo të ndotur.
5. Masat për trajtimin e mbetjeve dhe mbetjeve të rrezikshme.
6. Masat restauruese në rast mbylljeje të veprimtarisë.
7. Sanksionet në rast mosrespektimi të kushteve të autorizimit mjedisor.
8. Tarifa e autorizimit mjedisor.

Përgjegjësi i agjencisë rajonale të mjedisit

(_____)

UDHËZIM
Nr.16, datë 25.8.2010

**PËR DISA SHITESA E NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.1649, DATË 16.8.1999 “MBI
PLOTËSIMIN E DISA KUSHTEVE TË VEÇANTA NË TRANSPORTIN RRUGOR TË
UDHËTARËVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, nenit 9 dhe paragrafit të parë të nenit 36 të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar dhe të pikës 3 të nenit 236 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.153, datë 7.4.2000 “Rregullorja në zbatim të Kodit Rrugor”, të ndryshuar, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.1649, datë 16.8.1999 “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve”, të ndryshuar, të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, bëhen këto shtesa e ndryshime:

Neni 1

I. Në kapitullin III bëhen këto shtesa e ndryshme:

1. Pas togfjalëshit “këshillit të bashkisë” ose “këshillit bashkiak” shtohet togfjalëshi “ose të komunës”.

2. Pas fjalës “bashkisë” ose “bashkitë” shtohet togfjalëshi “ose komunës”.

3. Në fund të paragrafit të dytë të pikës 2, shtohet një paragraf tjetër me përmbajtjen si vijon më poshtë:

“Nuk lejohet qëndrimi i një autoveture në shërbimin taksi e licencuar në një njësi të qeverisjes vendore, në vendin e qëndrimit të autoveturave në shërbimin taksi të një njësie tjetër të qeverisjes vendore.”.

II. Në kapitullin IV bëhen këto shtesa e ndryshime:

1. Pika 2 riformulohet si vijon më poshtë:

“2. Për sa i përket pamjes së jashtme:

a) të kenë si rregull ngjyrën e verdhë ose ngjyrën, ose kombinimin e ngjyrave të përcaktuara nga bashkia, ku subjekti është licencuar në shërbimin taksi;

b) në ndryshim nga shkronja “a” e kësaj pike, autoveturat në shërbimin taksi të licencuara nga bashkitë jo-qendër rrethi/komuna nuk duhet të kenë ngjyrën e verdhë; dhe

c) autoveturat në shërbimin taksi të licencuara në bashkitë jo-qendër rrethi/komuna nuk duhet të kenë ngjyrën ose kombinimin e ngjyrave të njëjta me ngjyrën e autoveturave të licencuara në shërbimin taksi nga bashkitë qendër rrethi të të njëjtit rreth.”.

2. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me përmbajtje si vijon më poshtë:

“2/1 Autoveturat në shërbimin taksi në dyert anësore, përveç stampimit të fjalës “Taksi”, të kenë të vendosura, në mënyrë të dallueshme, tarifat në shërbimin taksi stemën e bashkisë/komunës, si dhe emërtimin e kodit, së bashku me numrin e serisë së licencës së bashkisë, ku subjekti taksi është licencuar në shërbimin taksi.”.

3. Pika 9 riformulohet si vijon më poshtë:

“9 a) Komisioni i DPSHTRR-së, në plotësimin e kushteve të komoditetit dhe të veçanta, pas verifikimit në plotësimin e kushteve të këtij kapitulli “Kushte të veçanta të automjetit në shërbimin taksi “TAKSI”, lëshojnë për autoveturën në shërbimin taksi dokumentin në përputhje me aneksin 3 të këtij udhëzimi. Aktvlerësimi i kushteve në shërbimin taksi për autoveturën në shërbimin taksi lëshohet çdo vit pasi autovetura ka kaluar kontrollin teknik periodik dhe vjetor dhe është pajisur me certifikatën e kontrollit teknik të mjeteve rrugore në përputhje me udhëzimin nr.2 datë 11.3.2010 “Mbi kontrollin teknik të mjeteve rrugore”.

b) Komisioni i DPSHTRR-së, në plotësimin e kushteve të komoditetit dhe të veçanta, nuk kryhen veprime lidhur me plotësimin e dokumentit sipas aneksit 3 të këtij udhëzimi, nëse një autoveturë e shërbimit taksi e licencuar në bashki jo-qendër rrethi/komunë ka ngjyrë të verdhë ose ngjyrën, ose kombinimin e ngjyrave të njëjta, me autoveturat e licencuara në shërbimin taksi në bashkinë qendër rrethi, si dhe kur nuk plotëson dispozitat e pikës 3 të nenit 236 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.153 “Rregullorja në zbatim të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe kapitullit IV të udhëzimit.

c) Aktvlerësimi i kushteve të komoditetit dhe të veçanta në shërbimin taksi është pjesë përbërëse e procedurës së licencimit. Ky dokument mund të pezullohet ose të hiqet gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe, ose refuzohet lëshimi i tij nga komisioni i DPSHTRR-së, derisa këto kushte të jenë plotësuar.

ç) Subjekti i autorizuar nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit për kontrollin teknik të automjeteve nuk kryen veprime nëse një autoveturë e shërbimit taksi e licencuar në bashki jo-qendër rrethi/komunë ose një autoveturë në përdorimin privat, e cila ka ngjyrë të verdhë ose ngjyrën, ose kombinim të ngjyrave të njëjta me autoveturat e licencuara në shërbimin taksi në bashkinë qendër rrethi të të njëjtit rreth.

d) Bashkitë jo-qendër rrethi/komuna nuk licencojnë subjekte në shërbimin taksi, nëse autoveturat në shërbimin taksi në bashkitë jo-qendër rrethi/komuna kanë ngjyrë të verdhë ose ngjyrën, ose kombinimin e ngjyrave të njëjta me autoveturat në shërbimin taksi bashki qendër rrethi të të njëjtit rreth.”.

4. Pas pikës 9 shtohet pika 9/1 me përmbajtjen, si vijon më poshtë:

“9/1 Nëse një autoveturë në shërbimin taksi nuk përdoret më për qëllime të destinacionit të saj, ajo nuk lejohet të përdoret si autoveturë private me ngjyrën e verdhë ose me ngjyrë, ose kombinim të ngjyrave të njëjta me atë të autoveturave në shërbimin taksi në bashkinë qendër rrethi.”.

5. Pas pikës 9/1 shtohet pika 9/2 me përmbajtje si vijon më poshtë:

“9/2 Në ndryshim nga shkronja “ç” pika 9/1, nga tjetërsimi i ngjyrës do të përjashtohen të gjitha autoveturat në përdorimin privat, kur ngjyra e verdhë është ngjyra origjinale e autoveturës nga prodhuesi.”.

Neni 2

Pika 2 e kapitullit VI riformulohet si vijon më poshtë:

“2. Tarifat e transportit të udhëtarëve qytetës, ndër-qytetës dhe rrethqytetës me autobus janë ato të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave nr.146, datë 26.2.1998 “Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve”, të ndryshuar.”.

Neni 3

Aneksi 3 riformulohet sipas aneksit bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Neni 4

Dispozita kalimtare

1. Bashkitë jo-qendër rrethi/komuna do të licencojnë subjekte në shërbimin taksi, si dhe kontrolli teknik i kryer nga subjekti i autorizuar nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Komisioni i DPSHTRR-së në plotësimin e kushteve të komoditetit dhe të veçanta do të kryejnë veprime, nëse autoveturat në shërbimin taksi në bashkitë jo-qendër rrethi/komuna kanë ngjyrë të verdhë ose ngjyrën, ose kombinimin e ngjyrave të njëjta me autoveturat në shërbimin taksi bashki qendër rrethi të të njëjtit rreth deri në ditën e botimit në Fletoren Zyrtare të këtij udhëzimi.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor merr të gjitha masat e nevojshme që të njoftojë të gjithë personat fizikë që zotërojnë autovetura private që, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, të mos tjetërsojnë ngjyrën e autoveturës duke bërë të verdhë ose ngjyrë, ose kombinim të ngjyrave të njëjta me atë të autoveturave në shërbimin taksi të bashkive qendër rrethi.

3. Brenda 12 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, zotëruesit e autoveturave në përdorimin privat, me përjashtim të atyre të pikës 9/2, të cilat janë të bojatisura me ngjyrën e verdhë ose me ngjyrë, ose kombinim të ngjyrave të njëjta me atë të autoveturave në shërbimin taksi në bashkinë qendër rrethi, do të tjetërsojnë ngjyrën e autoveturave të tyre.

4. Bashkitë qendër rrethi jo-qendër rrethi e komuna bashkëpunojnë nga afër me organet përgjegjëse, si Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, subjektin e autorizuar për kryerjen e kontrollit teknik nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Policinë Rrugore, Policinë Bashkiake dhe Policinë Tatimore në zbatimin e këtij udhëzimi.”.

Neni 5

Ky udhëzim do të hyjë në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
DREJTORIA E POLITIKAVE TË TRANSPORTIT RRUGOR

AKT VLERËSIMI
NË PLOTËSIMIN E KUSHTEVE TË KOMODITETIT DHE TË VEÇANTA TË AUTOVETURËS NË
SHËRBIMIN TAKSI

Lëshuar në zbatim të udhëzimit nr.1649, datë 16.8.1999 “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve”, të ndryshuar, kapitulli IV, komisioni i ngritur për kontrollin e plotësimit të kushteve të komoditetit dhe të veçanta në shërbimin taksi, kontrolloi autoveturën në shërbimin taksi.

Targa.....
 Marka.....
 Tipi.....
 Nr. shasisë.....
 Viti i prodhimit.....
 Nr. i vendeve.....
 Numri i lejes së qarkullimit.....
 Emri i subjektit transportues.....
 Adresa e plotë e subjektit.....
 Me seli në njësinë e qeverisjes vendore, bashkia/komuna.....
 Stema e njësisë së qeverisjes vendore.....
 Tarifat e shërbimit.....
 Ngjyra në përputhje me vendimin e njësisë së qeverisjes vendore.....

dhe pasi verifikoi të gjithë dokumentacionin e nevojshëm në përmbushjen e kërkesave të komoditetit e të veçanta që kërkon udhëzimi,

Komisioni vlerësoi:

Se autovetura e mësipërme plotëson kërkesat për shërbimin taksi të udhëtarëve sipas kapitullit IV të udhëzimit nr.1649, datë 16.8.1999 “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve”, të ndryshuar.

KOMISIONI

 (Emri, mbiemri, firma)

 (Emri, mbiemri, firma)

 (Emri, mbiemri, firma)

 (Emri, mbiemri, firma)

KRYETARI

 (Emri, mbiemri, firma)

Lëshuar, më _____ i vlefshëm deri _____

Shënim. Ky dokument mbahet në mjet, në origjinal.

UDHËZIM
Nr.1730, datë 27.8.2010

**PËR ZBATIMIN E STANDARDEVE TË SHËRBIMEVE TË PËRKUJDESIT SHOQËROR, PËR
PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA, NË QENDRAT REZIDENCIALE DHE DITORE**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 18 pika 4 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, si dhe në zbatim të pikës 2 të vendimit nr.822, datë 6.12.2006 të Këshillit të Ministrave “Për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për personat me aftësi të kufizuara në qendrat rezidenciale dhe ditore”,

UDHËZOJ:

Qendra rezidenciale dhe ditore, publike dhe jopublike, të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuara (PAK) ofrojnë shërbime në përputhje me standardet e miratuara dhe procedurat e mëposhtme:

1. Deklarata e qëllimit

1.1 Të gjitha institucionet rezidenciale dhe ditore, publike dhe jopublike, të kujdesit për PAK, hartojnë deklaratën e qëllimit, ku parashtrohet filozofia, synimet dhe objektivat e institucionit.

1.2 Në deklaratën e qëllimit përcaktohen misioni, objektivat dhe vlerat e shtëpisë/qendrës, shërbimet që ofrohen, struktura organike e qendrës, të dhënat për personelin, procedurat e shërbimeve, mbrojtja dhe siguria e PAK, lidhja me familjarët dhe të afërmit, procedura e ankimimit, largimit nga qendra etj. (Moduli 1: Udhëzues për deklaratën dhe standardet).

1.3 Deklarata e qëllimit. Ndhmon personelin dhe profesionistët të vlerësojnë nevojat e PAK dhe sistemimin e tyre në institucion; informon stafin, PAK dhe familjarët e tij për strukturën e qendrës dhe shërbimet që ofrohen; ndihmon drejtuesin për të marrë vendime për sistemimin e PAK dhe menaxhimin e institucionit.

1.4 Deklarata e qëllimit ekspozohet në një vend të dukshëm për personelin, PAK, familjarët, vizitorët, inspektorët e shërbimeve etj.

1.5 PAK, familjarët, të afërmit (vëllezërit, motrat etj.) duhet të konfirmojnë se janë njohur me deklaratën dhe disponojnë një kopje të saj.

1.6 Një udhëzues që përmban objektivat e institucionit, shërbimet social-mjekësore që ofrohen, respektimin e të drejtave dhe plotësimin e kërkesave të PAK, format e menaxhimit të institucionit, kërkesat strukturore, ambientale, organizative e funksionale dhe burimet njerëzore të qendrës, vihet në dizoacion të përfituesve dhe familjarëve.

1.7 Deklarata e qëllimit dhe udhëzuesi për PAK, hartohen duke përfshirë stafin e qendrës, profesionistët dhe familjarët e PAK (Moduli 2: Shembulli i një deklarate).

2. Vlerësimi i nevojave për PAK dhe mundësitë që ofron qendra për plotësimin e tyre

2.1 PAK marrin informacion me shkrim e me gojë për filozofinë e shërbimeve, ambientet e afuara dhe standardet e përkujdesjes.

2.2 Qendra harton një rregullore të brendshme, ku përcaktohen detyrimet e PAK dhe të personelit.

2.3 Personeli njihet me misionin, filozofinë e përkujdesjes dhe rregulloren e brendshme.

2.4 Institucionet përgatitin dhe shpërndajnë broshura/fletëpalosje/dokumente që përshkruajnë mjediset e qendrës dhe shërbimet që ofrohen. Ofruesit japin informacion rreth shërbimeve të mundshme.

2.5 Përdoruesve dhe familjarëve të PAK u krijohen kushte për të vizituar qendrën dhe informohen për të gjitha çështjet që lidhet me përfituesin.

2.6 Vlerësimi i nevojave të PAK realizohet nga ekipe multidisiplinare me profesionistët e qendrës në bashkëpunim me klientin dhe familjarët e tij, dhe mbi këtë bazë përcaktohen edhe shërbimet që do të ofrohen me klientët.

2.7 Një kontratë tip përcakton nevojat e identifikuar për shërbime ndaj klientit dhe mundësitë e plotësimit të tyre nga institucioni, e cila nënshkruhet nga përfaqësuesi i institucionit dhe përfituesi.

2.8 Në kontratë përcaktohet: misioni i institucionit, strategjia, objektivat, marrëdhëniet e institucionit me PAK, lista e shërbimeve dhe mjediset që ofron institucioni, të drejtat dhe detyrimet e përfituesit, marrëdhëniet me personelin, detyrimet e personelit etj. (Moduli 7: Kontrata tip. Moduli 8: Eliminimi i pengesave arkitektonike).

Plani i përkujdesit

Plani i përkujdesit për PAK përfshin masat që do të merren për plotësimin e nevojave të klientit. Për hartimin e planit të përkujdesit grumbullohet informacion i plotë për çdo përfitues, nëpërmjet intervistave me PAK dhe familjarët e tij. Mbi këtë bazë vlerësohen nevojat social-mjekësore dhe përcaktohet plani i shërbimeve që do të ofrohen për PAK në përputhje me gjendjen shëndetësore të klientit, moshën, gjininë, besimin fetar, etninë etj.

Për hartimin e planit të përkujdesit, plotësohen tri dokumente kryesore:

- Formulari i informacionit për PAK;
- Raporti për vlerësimin e nevojave të PAK;
- Plani i kujdesit për çdo PAK.

3. Formulari i informacionit për PAK

3.1 Formulari për informacionin e PAK ofron të dhëna të mjaftueshme, të cilat shërbejnë për hartimin e planit të përkujdesit.

3.2 Informacioni grumbullohet brenda javës së parë pas vendosjes së PAK në institucion.

3.3 Informacioni sigurohet nëpërmjet intervistave të drejtpërdrejta me PAK dhe familjarët e tij nga punonjësi social dhe ekspertët e tjerë të angazhuar për ofrimin e shërbimeve në institucion.

3.4 Formulari i informacionit përmban tetë rubrika me të dhëna të hollësishme: personale të PAK, të dhënat antropometrike, historinë e sëmundjes (anamneza) ekzaminimit klinik dhe ekzaminimet plotësuese, vaksinimet, sëmundjet dhe aftësitë e kufizuara të pranishme, problemet e zhvillimit dhe të dhëna të tjera.

3.5 Informacioni vihet në dispozicion të stafit profesional që punon drejtpërsëdrejti me PAK në institucionin rezidencial ose komunitar.

3.6 Përgjegjës për grumbullimin e informacionit dhe plotësimin e formularit është punonjësi social dhe pjesëtarët e ekipit multidisiplinar të profesionistëve të institucionit (Moduli 3: Formulari për informacionin e nevojshëm për PAK).

4. Raporti për vlerësimin e nevojave për PAK

4.1 Nevojat e PAK vlerësohen nga një ekip multidisiplinar me profesionistë, të cilët bashkëpunojnë për hartimin e planit individual të shërbimeve që do të ofrohen.

4.2 Vlerësimi i nevojave përfshin të gjitha aspektet social-shëndetësore të PAK: nevojat për shërbime sociale, shëndetësore, arsimore, ekonomike, lidhjet me familjen/të afërmit etj.

4.3 Vlerësimi i nevojave individuale të PAK përfundon brenda një muaji nga dita e pranimit të klientit në institucion.

4.4 Vlerësimi i nevojave përmbledhet në një raport të veçantë, i cili përmban pesë rubrika, ku pasqyrohet gjendja aktuale e PAK: mosfunksionimi motorik dhe fin, çrregullimet e sjelljes, vështirësitë në komunikim, vështirësitë në arsimin special, veprimtaritë aplikative krijuese etj.

4.5 Raporti i vlerësimit të nevojave dhe ecurisë detajohet për fushat: e pavarësisë praktike, psikomotorikës, zhvillimin e shqisave, gjuhën dhe komunikimin, përafrimin e shifrave dhe numrave, aktivitetet në atelietë e punës etj. (Moduli 4: Raporti i vlerësimit të nevojave dhe ecurisë së PAK).

5. Plani i kujdesit

5.1 Plani i kujdesit mbështetet në objektivat afatmesëm e afatgjatë të nevojave të shërbimeve për PAK.

5.2 Plani i kujdesit hartohet brenda dy muajve pas pranimit të klientit në institucion.

5.3 Punonjësi social dhe ekipi multidisiplinar i ngritur, bashkëpunojnë me punonjësit e tjerë që angazhohen për hartimin e planit të shërbimeve për PAK.

5.4 Plani i kujdesit për PAK përbëhet nga dy pjesë: pjesa e parë përfshin planin e përgjithshëm të qendrës për shërbimet që do të ofrohen për PAK dhe përmban informacionin individual të klientit, burimet ekonomike, preferencat, sistemimin në institucion etj. (Moduli 5: Pjesa e parë).

5.5 Pjesa e dytë e planit përbëhet nga: plani i shërbimeve që lidhen me rikuperimin shëndetësor të PAK, ku trajtohen gjashtë fusha: pavarësia praktike, e cila zhvillohet në pesë disiplina; psikomotorika, që zhvillohet në tetë disiplina; zhvillimi i shqisave, ku zhvillohen pesë disiplina; gjuha dhe komunikimi, që zhvillohen në katër disiplina; përafrimi i shifrave dhe numrave, që zhvillohet në pesë disiplina dhe aktivitete zhvilluese nëpërmjet punës sipas nevojave të PAK dhe mundësive që ofron qendra.

5.6 Plani i kujdesit analizohet dhe rishikohet dy herë në vit.

5.7 Procedurat e veçanta shëndetësore ndaj PAK kryhen vetëm me autorizimin me shkrim të mjekut ose të infermierit. Të gjitha shërbimet mjekësore evidentohen duke mbajtur shënime në dokumente të veçanta (Moduli 5: Pjesa e dytë, plani i kujdesit).

6. Raporti i ecurisë

6.1 Drejtori i institucionit është përgjegjësi kryesor për të analizuar gjendjen dhe progresin e shërbimeve për PAK. Raporti për vlerësimin e nevojave dhe plani i kujdesit për PAK rishikohen dy herë në vit.

6.2 Në procesin e analizës dhe rishikimit të planeve marrin pjesë PAK dhe familjarët ose të afërmit e tij.

6.3 Drejtori dhe punonjësi social sigurojnë pjesëmarrjen e anëtarëve të stafit dhe të ekipit multidisiplinar në procesin e analizës dhe në mbledhjen e rishikimit të planit të shërbimeve për PAK.

6.4 Ndryshimet dhe rekomandimet që bëjnë profesionistët dhe anëtarët e ekipit multidisiplinar reflektohen në planin e rishikuar të kujdesit të PAK.

6.5 Inspektori i shërbimeve sociale i SHSSH-së merr pjesë në mbledhjen dhe rishikimin e planit të shërbimeve të PAK.

7. Respektimi i intimitetit dhe dinjitetit të klientit gjatë shërbimeve personale higjienike.

7.1 PAK gjatë kryerjes së shërbimeve u sigurohet kujdes për ruajtjen e intimitetit. Klientët që janë të aftë plotësisht nga ana fizike, lejohen dhe nxiten t'i kryejnë veprimet (banjë/dush) në mënyrë autonome pa praninë e stafit.

7.2 Në planin individual të PAK reflektohet kriteri i kryerjes së shërbimeve të kujdesit higjienik në mënyrë të pavarur.

7.3 Personeli duhet të ketë kualifikimin e duhur për të siguruar respektimin e të drejtave për intimitetin e klientit.

7.4 Punonjësit duhet të kenë dëshmi për kualifikimet përkatëse në përputhje me shërbimet që ofron secili profesionist. Dëshmitë e kualifikimit vendosen në dosjet e tyre personale (Moduli 6: Mbrojtja e PAK, udhëzime dhe procedura).

8. Jeta sociale në shtëpi dhe lidhjet me komunitetin

8.1 Qendra harton planin e aktiviteteve sociale në bashkëpunim me PAK dhe familjarët.

8.2 Plani i aktiviteteve sociale rishikohet një herë në muaj.

8.3 PAK nxiten të marrin pjesë në aktivitete në përputhje me mundësitë dhe preferencat e tyre.

8.4 PAK kanë të drejtë të presin vizitorë dhe të marrin pjesë në aktivitete familjare.

9. Autonomia dhe zgjedhja

9.1 PAK ushtrojnë të drejtën për të vendosur për jetën e tyre dhe për të përfituar ndihmën e kërkuar.

9.2 PAK nxiten të marrin pjesë në vendimet që merren për jetesën në qendër dhe për realizimin e aktiviteteve që organizohen.

9.3 PAK përfshihen dhe të japin mendime për shërbimet dhe rregullat e vendosura për orarin e ngrënies, aktivitetet, orarin e fjetjes, takimin me vizitorët etj.

9.4 Personeli kualifikohet për nxitjen e autonomisë dhe zgjedhjes (Moduli 6: Mbrojtja e PAK).

10. Vaktet e ngrënies

10.1 Ushqyerja duhet të garantojë plotësimin e nevojave ushqimore të klientit në përputhje edhe me kërkesat dietike të vendosura nga specialistët e shëndetit publik.

10.2 Buxheti për ushqimin të jetë i mjaftueshëm për të përmbushur nevojat dietike.

10.3 Klientët me nevoja dietike të kenë ushqim të veçantë që të plotësojë nevojat bazë në sasi e cilësi.

10.4 PAK inkurajohen dhe përfshihen në planifikimin e menysë, blerjen e ushqimeve, përgatitjen e vakteve, orarin e ngrënies dhe shtrimin e tavolinës për ngrënie.

10.5 Intervistat me PAK dëshmojnë për plotësimin e standardeve të ushqimit të tyre.

10.6 PAK kanë të drejtën të mbajnë disa ushqimeve në ambientet e tyre në kushte të përshtatshme higjienike (Moduli 7: Kontrata TIP).

11. Mbrojtja e të drejtave të PAK, shmangia e abuzimit dhe procesi i ankimit

11.1 PAK iu garantohen të gjitha të drejtat ligjore të mbrojtjes nga abuzimet fizike, psikologjike, seksuale, financiare etj.

11.2 Personeli që punon me klientët duhet të provojë me dëshmi të gjendjes gjyqësore që është i padënuar. Personelit i ndalohet marrja e dhuratave (para, sende etj.) dhe nëse provohet e kundërta, ndaj tyre vendosen sanksione nga autoritet shtetërore përgjegjëse, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

11.3 Në rregulloren e brendshme ka procedura për raportimin e rasteve të abuzimit, ku përcaktohen afatet e kthimit të përgjigjes dhe emrat e personave/organeve që do të merren me ankesën.

11.4 Inspektimi i ankesave nga inspektorët e shërbimeve sociale, vërteton se ato janë trajtuar me seriozitet dhe në kohën e duhur.

11.5 Drejtuesit, ekspertë të qendrës trajnohen dhe sensibilizohen në lidhje me llojet e abuzimit dhe trajtimin e të abuzuarve (Moduli 6: Mbrojtja e PAK, udhëzime dhe procedura).

12. Shtëpia, mjediset e banimit dhe pajisjet e saj

12.1 Qendra duhet të vendoset në një lagje sa më afër shtëpive të tjera të banimit.

12.2 Qendra ka mjedise të përbashkëta për ndenje, aktivitete, ngrënie etj.

12.3 Mobilimi i dhomës së gjumit plotëson nevojat jetike të klientëve dhe pajisjet me: krevate të përshtatshme, perde, pasqyra, komo, raft rrobash, tryezë etj. Mjedisi garanton mbajtjen e sendeve personale.

12.4 Qendra ka furnizim të rregullt me ujë, elektricitet, ngrohje dhe freskim.

12.5 Shtëpia plotëson kushtet higjieno-sanitare dhe sigurinë nga zjarri (Moduli 8: Material ndihmës, hapësirat e brendshme, karakteristikat e shërbimeve higjienike, eliminimi i barrierave arkitektonike, aksesoret dhe përbërësit bazë të ndërtesës).

13. Kompletimi me personel të mjaftueshëm e të kualifikuar të qendrës

13.1 Qendra siguron numrin e nevojshëm të personelit në përputhje me nevojat e klientëve.

13.2 Në çdo turn ka një numër të mjaftueshëm të stafit, të cilët ofrojnë shërbime në përputhje me standardet e kërkuara. Personeli trajnohet në përputhje me nevojat e klientëve.

13.3 Profesionistët, ekspertët kanë përshkrimet e vendeve të punës, ku përcaktohen përgjegjësitë, detyrat, arsimit, kualifikimi etj.

13.4 Puna e personelit vlerësohet një herë në vit. Raporti i vlerësimit të personelit nënshkruhet si nga personi të cilit i bëhet vlerësimi, ashtu edhe nga personi që kryen vlerësimin.

13.5 Procedurat e punësimit janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe Kodin e Punës.

13.6 Në çdo turn ka një person që përgjigjet për mbarëvajtjen e punës (Moduli 9: Roli dhe detyrat e specialistëve në qendrat e zhvillimit për PAK. Moduli 7: Kontrata TIP).

14. Drejtimi, ruajtja e dokumentacionit dhe procedurat financiare

14.1 Institucioni drejtohet nga një person me përvojën dhe kualifikimet e nevojshme, për të organizuar punën në aspektin administrativ, financiar dhe profesional që njeh problematikën e PAK.

14.2 Drejtuesi duhet të ketë së paku 5 vjet përvojë pune në fushën e përkujdesjes shoqërore në fushën e aftësisë së kufizuar, të ketë arsim të lartë në shkencë sociale (punë sociale, mjekësi, infermieri, psikologji, sociologji, ekonomik, juridik, mësuesi).

14.3 Drejtuesi i qendrës garanton që dokumentacioni i klientit dhe i personelit të jetë konfidencial në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale". Dokumentacioni mbahet në një vend të sigurt. Vetëm disa persona mund të shohin dosjen e klientit dhe të personelit.

14.4 Administrimi i dokumentacionit ekonomik e financiar bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Spiro Ksera

UDHËZIM
Nr.33, datë 24.9.2010

**PËR TRAJTIMIN E KREDIVE TË TRANSFERUARA NGA BANKAT E NIVELIT TË DYTË ME
KAPITAL TËRËSISHT SHTETËROR NË AGJENCINË E TRAJTIMIT TË KREDIVE,
KRITERET DHE KUSHTET PËR NDRYSHIMIN E MARRËVESHJES SË KREDISË, SI DHE
PROCEDURAT E MARRJES NË PRONËSI TË PASURIVE TË LËNA SI GARANCI OSE JO
NGA HUAMARRËSIT, TË ADMINISTRIMIT, SHITJES DHE DHËNIES ME QIRA APO ME
ENFITEOZË TË KËTYRE PASURIVE**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 9731, datë 10.5.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8894, datë 14.5.2002 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”, të ndryshuar, dhe pikës 1 kreu IV të vendimit nr.681, datë 11.6.2009 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin e kredive të transferuara nga bankat e nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror në Agjencinë e Trajtimit të Kredive, për kriteret dhe kushtet për ndryshimin e marrëveshjes së kredisë, si dhe procedurat e marrjes në pronësi të pasurive të lëna si garanci ose jo nga huamarrësit, të administrimit, shitjes dhe dhënies me qira apo me enfiteozë të këtyre pasurive”, të ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

HYRJE

Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i procedurave dhe përgjegjësiqe që Agjencia e Trajtimit të Kredive (ATK), duhet të ndjekë në zbatim të vendimit nr.681, datë 11.6.2009 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin e kredive të transferuara nga bankat e nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror në Agjencinë e Trajtimit të Kredive, kriteret dhe kushtet për ndryshimin e marrëveshjes së kredisë, si dhe procedurat e marrjes në pronësi të pasurive të lëna si garanci ose jo nga huamarrësit, të administrimit, shitjes dhe dhënies me qira apo me enfiteozë të këtyre pasurive”, të ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.450, datë 16.6.2010.

Ky udhëzim ka për qëllim njohjen dhe sensibilizimin e debitorëve që trajton ATK-ja, për lehtësitë e ofruara në likuidimin e detyrimit, nëpërmjet trajtimit ekonomik dhe ligjor të tij sipas kushteve dhe procedurave për përfitimin ose jo të lehtësive të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.681, datë 11.6.2009, të ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.450, datë 16.6.2010.

Procedurat dhe kushtet për përfitimin e lehtësive, përcaktohen në një marrëveshje të re të ristrukturimit të kredisë. Marrëveshja e re e ristrukturimit lidhet ndërmjet Agjencisë së Trajtimit të Kredive dhe debitorit, i cili afrohet për likuidimin përfundimtar ose me këste të detyrimit. Në këtë marrëveshje palët kanë të drejtë të përcaktojnë kushtet për përfitimin e lehtësive, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi, të cilat janë të detyrueshme për t’u zbatuar nga palët.

Me miratimin e këtij udhëzimi, lehtësitë që afron ligji nr.9731, datë 10.5.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8894, datë 14.5.2002 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”, i ndryshuar dhe vendimi i Këshillit të Ministrave dalë në zbatim të tij nr.681, datë 11.6.2009, të ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.450, datë 16.6.2010, i përfitojnë të gjithë debitorët që plotësojnë kriteret, kushtet dhe afatet e parashikuara në këtë udhëzim.

KREU I
TRAJTIMI I KREDIVE TË TRANSFERUARA NGA BANKAT E NIVELIT TË DYTË ME
KAPITAL TËRËSISHT SHTETËROR

Të gjithë debitorët që likudojnë menjëherë principalin e transferuar apo atë të mbetur, pavarësisht nga objekti i kredisë dhe shuma e principalit të transferuar apo atij të mbetur në trajtim, përfitojnë faljen e të gjitha interesave, kamatëvonesave, gjobave të transferuara nga bankat e nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror dhe ato të llogaritura në ATK.

Debitorët që afrohen të likudojnë me këste, përfitojnë falje të pjeshme dhe të përshkallëzuar të interesave, kamatëvonesave dhe gjobave, në varësi të shumës së principalit të transferuar.

Për efekt të zbatimit të kërkesave të këtij udhëzimi, trajtimi i debitorëve bëhet duke i grupuar sipas shumës së principalit të transferuar dhe sipas statusit aktual të debitorit. Bazuar në këtë klasifikim, ATK-ja nëpërmjet ndryshimit të marrëveshjes së kredisë me debitorin, ka të drejtë të ristrukturojë detyrimin me kushtet si më poshtë:

A. Debitorët e klasifikuar sipas shumës së principalit të transferuar nga bankat

1. Për debitorët, të cilët, në datën e transferimit të kredisë nga bankat, e kanë pasur shumën e principalit deri në 3 000 000 (tre milionë) lekë:

a) faljen në masën 90% të interesave, kamatëvonesave dhe gjobave të transferuara dhe llogaritura në ATK.

2. Për debitorët, të cilët, në datën e transferimit të kredisë nga bankat, e kanë pasur shumën e principalit mbi 3 000 000 (tre milionë) lekë:

a) faljen në masën 95% të interesave, kamatëvonesave dhe gjobave të transferuara dhe llogaritura në ATK.

3. Periudha e pagesës së shumës së mbetur të detyrimit nuk mund të jetë më e gjatë se 2 (dy) vjet, nga data e lidhjes së kontratës së re të ristrukturimit.

B. Debitorët e klasifikuar sipas statusit aktual në ATK

1. Debitorët e vdekur

a) Për debitorët e vdekur, pavarësisht nga shuma e kredisë, të përcaktuar në pikën A, u kërkohet trashëgimtarëve të tyre të likudojnë vetëm shumën e principalit të mbetur në momentin e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi.

b) Periudha e pagesës së shumës së mbetur të kredisë nuk mund të zgjatet më shumë se 3 vjet, nga data e lidhjes së kontratës së re të ristrukturimit.

2. Debitorët pas ekzekutimit të kolateralit

a) Debitorë pas ekzekutimit të kolateralit do të konsiderohen:

- debitorë, të cilëve kolateralet e vëna garanci u janë shitur nga zyra e përmbartimit;

- debitorë, të cilëve kolateralet e vëna garanci u janë shitur nga ATK-ja, pasi janë marrë në pronësi nëpërmjet procedurave përmbartimore;

- debitorë, të cilëve kolateralet u janë marrë në pronësi nga ATK-ja nëpërmjet procedurave përmbartimore.

b) Debitorët, të cilëve u kanë përfunduar procedurat e shitjes së kolateralit dhe janë sërish debitorë të Agjencisë së Trajtimit të Kredive, gëzojnë të drejtën e ristrukturimit sipas përcaktimeve të kreut I të këtij udhëzimi dhe do t'u kërkohet likuidimi i vetëm 50% e detyrimit të mbetur pas ristrukturimit, me përjashtim të rasteve kur këto llogari rezultojnë me pozicion kreditorë.

3. Debitorët me detyrim të transferuar nga ish-bankat e nivelit të dytë, vetëm si interesa, penalitete dhe/apo kamatëvonesa

a) Debitorët me detyrim të transferuar nga ish-bankat e nivelit të dytë, vetëm si interesa, penalitete dhe/apo kamatëvonesa, përfitojnë faljen në masën 100% të tyre.

b) Në këtë grup përfshihen edhe ata debitorë, të cilëve interesat, penalitetet dhe/apo kamatëvonesat iu janë transferuar të ndara nga principalin, pas datës së hartimit të procesverbaleve të transferimit të detyrimit nga ish-bankat e nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror.

4. Debitorë të transferuar për shpenzime gjyqësore dhe përmbarimore
 - a) Detyrimet e transferuara nga bankat dhe ato të krijuara në ATK, të përbëra nga shpenzime gjyqësore dhe/ose përmbarimore, nuk falen dhe i shtohen detyrimit të mbetur.

KREU II

KRITERET DHE KUSHTET QË DUHEN PLOTËSUAR PËR NDRYSHIMIN E MARRËVESHJES SË KREDISË, ZËVENDËSIMIN E DEBITORIT DHE KOLATERALIT

Zbatimi i kriterëve dhe kushteve për ndryshimin e marrëveshjes së kredisë fillon pasi debitori ka paraqitur kërkesën me shkrim për likuidim të menjëhershëm ose me këste të detyrimit, pranë ATK-së (në Drejtorinë e Përgjithshme ose në zyrat rajonale), të shoqëruar me fotokopje të dokumentit të identifikimit.

1. Kur kërkesa e debitorit është për likuidim të menjëhershëm të detyrimit

a) Kur kërkesa e debitorit është për likuidim të menjëhershëm të detyrimit, strukturat përkatëse të ATK-së llogaritin principalin e transferuar ose të mbetur duke i zbritur arkëtimet e bëra në ATK (pavarësisht se ato mund të jenë kontabilizuar për interesa, gjoba e kamatëvonesë), duke i shtuar atij shpenzimet gjyqësore, përmbarimore apo të tjera (nëse ka) dhe shuma e nxjerrë i njoftohet zyrtarisht debitorit, i cili duhet të bëjë pagesën brenda 10 ditëve.

b) Pas kryerjes së pagesës nga debitori, drejtoria e ATK-së, pasi kryen verifikimet përkatëse, miraton me vendim të posaçëm: shlyerjen përfundimtare të detyrimit, lëshimin e vërtetimit që debitori nuk ka më detyrime ndaj ATK-së, kërkon pushimin e veprimeve përmbarimore, si dhe çlirimin e barrës hipotekore, nëse debitori ka lënë garanci të tilla.

2. Kur kërkesa e debitorit është për likuidim me këste të detyrimit

a) Kur kërkesa e debitorit është për likuidim me këste të detyrimit, strukturat përkatëse të ATK-së llogaritin detyrimin e mbetur për t'u paguar, sipas përcaktimeve në kreun I të këtij udhëzimi, duke i zbritur arkëtimet e bëra në ATK (pavarësisht se ato mund të jenë kontabilizuar për interesa, gjoba e kamatëvonesë) dhe i shtojnë atij shpenzimet gjyqësore, përmbarimore apo të tjera (nëse ka). Shuma e nxjerrë i njoftohet zyrtarisht debitorit.

b) Me të marrë njoftimin për detyrimin që duhet të paguajë, debitori brenda 10 ditëve duhet të paguajë menjëherë jo më pak se 20% të principalit të transferuar apo shumës së mbetur prej tij.

c) Pas konfirmimit zyrtar të kësaj pagese (jo më pak se 20% të principalit të transferuar apo shumës së mbetur prej tij), drejtoria e ATK-së, nëpërmjet strukturave të saj, miraton brenda 5 ditëve ristrukturimin e kredisë, duke lidhur kontratën përkatëse të ristrukturimit për likuidimin me këste të detyrimit të mbetur sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në kreun I të këtij udhëzimi, si dhe kërkon pezullimin e veprimeve përmbarimore në rast se debitori është në ndjekje ligjore.

ç) Këstet e pagesës së detyrimit të mbetur mund të përcaktohen të barabarta ose të diferencuara në varësi të kushteve ekonomike të secilit debitor, por jo më vonë se afati i maturimit të kontratës së ristrukturimit (2 vjet).

3. Garancitë dhe kushtet e tjera për marrëveshjen e ristrukturimit të kredisë

a) Si garanci për marrëveshjen e ristrukturimit të huas janë kolateralet që debitori ka vendosur në aktdetyrimin e marrjes së kredisë.

b) Për pasuritë që janë vënë garanci (gjithmonë pasuri të paluajtshme), debitori duhet të paraqesë të gjithë dokumentacionin e pronësisë të lëshuar nga ZVRPP përkatëse (vërtetim pronësie nga dokumentet hipotekore ose certifikatë për vërtetim pronësie, kartelën e pasurisë së paluajtshme, hartën treguese).

c) Debitorët të cilët nuk paguajnë në afat 4 këste mujore apo 2 këste 3-mujore radhazi, me miratim të drejtorisë së ATK-së, kontrata e ristrukturimit anulohet dhe debitori humbet të gjitha lehtësitë e përfituara nga kjo kontratë, duke u trajtuar më tej si të gjithë debitorët e paristrukturuar.

ç) Modeli i kontratës së ristrukturimit do të hartohet në bazë të dispozitave të Kodit Civil dhe miratohet nga drejtoria e ATK-së.

d) Të gjitha shpenzimet për procedurën e ristrukturimit paguhen nga debitori.

e) Debitori ka të drejtë të kërkojë vetëm një herë ristrukturimin e detyrimit, sipas të njëjtave lehtësira të parashikuara në këtë udhëzim, pavarësisht nga faza e trajtimit në të cilën ndodhet.

f) Kriteret, kushtet dhe afatet e përcaktuara në këtë udhëzim, për ristrukturimin e detyrimit, nuk e pengojnë Agjencinë që në çdo kohë, kur mungon bashkëpunimi i debitorit, të kërkojë arkëtimin ligjor të detyrimit në masën e kontabilizuar në ATK, nëpërmjet procedurave përmbarimore për ekzekutimin e detyrueshëm.

g) Të gjithë debitorët që kanë lidhur kontrata ristrukturimi, gëzojnë përsëri të drejtën e trajtimit sipas kushteve favorizuese të përcaktuara në këtë udhëzim.

4. Krite dhe kushte të përbashkëta

a) Llogaritja e interesave për debitorët që nuk u ka dalë urdhri i ekzekutimit do të shtrihet deri në datën 30.4.2009, veprim ky, i cili pasqyrohet në kontabilitetin e ATK-së.

b) Debitorëve të cilëve u ka dalë urdhërekzekutimi përpara datës 30.4.2009, interesat do të llogariten deri në datën e shpalljes së tij (kur urdhri i ekzekutimit ka dalë pa shumë).

c) Për kreditë e transferuara në valutë, llogaritja e detyrimit të ri do të bëhet e konvertuar me kursin fiks të Bankës së Shqipërisë në momentin e transferimit të tyre nga ish-bankat.

ç) Kushtet lehtësuese, të përcaktuara në këtë udhëzim, i përfitojnë të gjithë debitorët që janë në ndjekje ligjore në gjykatë ose përmbarim, pavarësisht nga faza e trajtimit në të cilën ndodhen duke paguar paraprakisht shpenzimet gjyqësore dhe ato përmbarimore.

d) Në të gjitha rastet e aplikimit të lehtësive të parashikuara në këtë udhëzim, shumat e detyrimit të mbetur për t'u likuiduar nuk mund të jetë asnjëherë më e vogël sesa shumata e principalit të transferuar apo atij të mbetur, pavarësisht se ajo mund të rezultojë si e tillë nga llogaritjet e bëra.

e) Në rast se debitori ka dy kredi të ndryshme për të likuiduar, ku njëra prej tyre është e siguruar me dorëzani, shlyerja e saj shoqërohet me çlirimin e barrës hipotekore të dorëzanës, pavarësisht se kredia tjetër nuk është likuiduar. Kjo praktikë mund të aplikohet edhe në rast se garancitë pasurore janë që të gjitha të debitorit, por ai likuidon një prej këtyre kredive, me kusht që kolaterali i mbetur të mbulojë në masën 150% detyrimin që rrjedh nga kreditë e palikuiduara.

5. Zëvendësimi i debitorit

a) Zëvendësimi i debitorit, përveç parashikimeve në aktet ligjore e nënligjore specifike për ATK-në, mban parasysh edhe kërkesat e neneve 496, 497 e 498 të Kodit Civil, kur gjykohet se ky veprim është në interes të kthimit të kredisë.

b) Zëvendësimi i debitorit bëhet në rastet kur debitori i ri paraqet garanci më të larta financiare për shlyerjen e detyrimit sesa debitori ekzistues të cilat shoqërohen me një plan të ri biznesi që i paraqitet ATK-së. Në këtë kuadër, para nënshkrimit të kontratës përkatëse, debitorit të ri i kërkohet likuidimi i menjëhershëm i 50% të principalit të transferuar apo atij të mbetur, si dhe garanci hipotekore në masën 150% të detyrimit të mbetur për t'u likuiduar, i cili përfshin rivlerësimin e kolateralit ekzistues dhe vlerën e një kolateralit tjetër të shtuar nga debitori i ri.

c) Pagesa në masën 50% të principalit të transferuar apo atij të mbetur, zbritet nga detyrimi i kontabilizuar i debitorit ekzistues dhe diferenca përbën detyrimin që mbetet për t'u shlyer nga debitori i ri.

ç) Procedura e zëvendësimit të debitorit fillon me paraqitjen dhe miratimin në parim të kërkesës së të interesuarve, e shoqëruar me prezantimin e garancive financiare (planbiznesit) dhe garancive hipotekore nga debitori i ri dhe vazhdon me etapat e miratimit të saj nga strukturat përkatëse të ATK-së.

d) Pas miratimit në parim të zëvendësimit të debitorit, i interesuari paraqet pranë ATK-së të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të pronësisë të lëshuar nga ZVRPP (certifikatën për vërtetim pronësie, kartelën e pasurisë së paluajtshme dhe hartën treguese ose vërtetim pronësie nga dokumentet hipotekore) mbi bazën e të cilave do të hartohet kontrata e hipotekimit, e cila paraprihet nga një deklaratë noteriale e debitorit të ri dhe e pjesëtarëve madhorë të familjes së tij (të vërtetuar nga certifikata e përbërjes familjare, të lëshuar nga zyra e gjendjes civile përkatëse ku figuron i regjistruar debitori i ri), e cila përmban nënshkrimin e tyre për kryerjen e këtij veprimi.

e) Vlerësimi i pasurive të paluajtshme që do të vihen garanci nga debitori i ri kryhet nga ekspertë të licencuar për këtë qëllim.

f) Debitori i ri përfiton të drejtën e ristrukturimit të detyrimit të mbetur, ashtu si edhe debitorët e tjerë sipas kushteve të përcaktuara në kreun I të këtij udhëzimi.

g) Në çdo rast zëvendësimi debitori, garancitë hipotekore, të dhëna nga debitori i parë, nuk çlirohen nga barra hipotekore deri në shlyerjen përfundimtare të detyrimit nga debitori i ri.

h) Të gjitha shpenzimet që kryhen për realizimin e procedurave për zëvendësimin e debitorit përballohen nga debitori i ri.

6. Zëvendësimi i kolateralit

a) ATK ka të drejtë të zëvendësojë kolateralin, me kërkesën e debitorit kur ky veprim është në interes të shlyerjes së kredisë dhe plotësohen kushtet e mëposhtme:

- Zëvendësimi i kolateralit realizohet kur vlera e pasurisë së re, e cila do të ngarkohet me barrë hipotekore mbulon të paktën 150% të detyrimit të mbetur.

- Kërkesa e debitorit për zëvendësimin e kolateralit, pasi miratohet në parim nga Drejtoria e ATK-së, shoqërohet me paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për kryerjen e këtij veprimi nga i interesuari, i cili përmban dokumentacionin e pronësisë të lëshuar nga ZVRPP (certifikatën për vërtetim pronësie, kartelën e pasurisë së paluajtshme dhe hartën treguese ose vërtetim pronësie nga dokumentet hipotekore), si dhe raportvlerësimin përkatës nga ekspertë të licencuar për këtë qëllim.

- Procedura e zëvendësimit të kolateralit shoqërohet me pagesën nga debitori të 20% të principalit të transferuar apo atij të mbetur.

- Pas kryerjes së procedurave të mësipërme, drejtoria e ATK-së merr vendim përfundimtar për zëvendësimin e kolateralit.

- Për pasuritë që do të vendosen si garanci e re, hartohet një kontratë hipotekimi përpara noterit publik, ku duhet të nënshkruajnë detyrimisht edhe anëtarët madhorë të familjes së debitorit (të vërtetuar nga certifikata e përbërjes familjare, të lëshuar nga zyra e gjendjes civile përkatëse ku figuron i regjistruar debitori i ri).

- Çlirimi i barrës hipotekore për pasurinë ekzistuese të vënë garanci do të bëhet atëherë kur nga ZVRPP-ja të konfirmohet regjistrimi i kontratës së re të hipotekimit e shoqëruar me lëshimin e dokumentit përkatës që vërteton ngarkimin me barrë hipotekore të pasurisë së re.

- Të gjitha shpenzimet që kryhen për realizimin e procedurave për zëvendësimin e kolateralit përballohen nga debitori.

KREU III

PROCEDURAT E MARRJES NË PRONËSI TË PASURIVE TË LËNA SI GARANCI OSE JO NGA DEBITORËT, TË ADMINISTRIMIT, SHITJES E DHËNIES ME QIRA APO ME ENFITEOZË TË KËTYRE PASURIVE

1. Këtij udhëzimi u nënshtrohen të gjitha pasuritë e luajtshme dhe/ose të paluajtshme të lëna garanci ose jo nga debitorët e Agjencisë së Trajtimit të Kredive, të cilat kalojnë në pronësi të saj, në bazë të neneve 557 dhe 577 të Kodit të Procedurës Civile, pasi nuk janë shitur në ankandet e zhvilluara nga përmbaruesi gjyqësor, në zbatim të procedurave ligjore për ekzekutimin e detyrueshëm të detyrimit.

2. Marrja në pronësi e pasurive të lëna garanci ose jo nga debitorët, të sekuestruara nga përmbaruesi gjyqësor, bëhet me pëlqimin e drejtorisë së ATK-së, si palë kreditore, kundrejt vlerës së ankandit të fundit të zhvilluar nga përmbaruesi gjyqësor.

3. Propozimin për marrjen në pronësi të sendit, përmbaruesi gjyqësor e dërgon në Drejtorinë e Përgjithshme të ATK-së, e cila brenda afateve ligjore është e detyruar të marrë vendim për marrjen ose jo në pronësi të sendit të sekuestruar. Propozimi i përmbaruesit gjyqësor duhet të përmbajë të dhëna për vlerën e ankandit të fundit dhe të dhëna të tjera të evidentuara në procesverbalin e sekuestrimit dhe ato të ankandeve të zhvilluara.

4. Për marrjen në dorëzim të sendit, punonjësi i autorizuar nga ATK-ja mban një procesverbal me përmbaruesin gjyqësor, i cili është i detyruar ta dorëzojë sendin të lirë, si nga debitori, ashtu dhe nga çdo posedues tjetër. Gjithashtu personi i autorizuar, sipas rastit, bën aplikimet përkatëse në ZVRPP, DRSHTRR ose institucione të tjera të ngarkuara me ligj, për pajisjen me dokumentin e pronësisë, pasi përmbaruesi gjyqësor të ketë dërguar një kopje të vendimit përkatës në këto institucione.

5. Pas përfundimit të procedurave për marrjen në dorëzim të sendit dhe regjistrimit në pronësi të ATK-së, plotësohet dosje e veçantë me dokumentacionin e plotë tekniko-ekonomiko-ligjor, një kopje e së cilës arkivohet në dosjen e debitorit. Njëkohësisht drejtorja e ATK-së merr vendim për regjistrimin në kontabilitet të vlerës së sendit të marrë në pronësi nëpërmjet procedurave përbarimore.

6. ATK-ja është përgjegjëse për ruajtjen dhe administrimin e sendit të marrë në pronësi, sipas rregullave të përcaktuara në ligjin nr.6942, datë 25.12.1984 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare”, të ndryshuar, dhe vendimeve të Këshillit të Ministrave nr.70, datë 11.3.1985 dhe nr.445, datë 25.12.1990. Në raste të veçanta, mund të vendoset edhe për ruajtjen fizike ose elektronike të sendeve të marra në pronësi. Kur sendi është i luajtshëm, në rast të pamundësisë për ta magazinuar në ambientet përkatëse të ATK-së, ai mund të ruhet kundrejt pagesës, në magazina ose vende parkimi në pronësi të personave të tretë.

7. Shpenzimet për ruajtjen dhe administrimin e sendeve të marra në pronësi i shtohen vlerës së detyrimit të debitorit.

8. Pas kontabilizimit të sendit të marrë në pronësi, ATK-ja, kundrejt shlyerjes së menjëhershme të detyrimit të ristrukturuar, sipas përcaktimeve të bëra në kreun I të këtij udhëzimi, i propozon debitorit kthimin e sendit të marrë në pronësi, nëpërmjet një kontrate shkëmbimi me të. Debitori ose përfaqësuesi ligjor i tij duhet të kthejë përgjigje brenda 15 ditëve nga data e njoftimit.

9. Në rast se debitori refuzon propozimin e ATK-së ose nuk kthen përgjigje brenda afatit 15-ditor, me vendim të drejtorisë, ATK-ja fillon procedurat e shitjes me ankand të sendit.

10. ATK-ja ka të drejtën e rivlerësimit të pronës para fillimit të procedurave të shitjes me ankand, me kusht rritjen e vlerës fillestare, kur e gjykon të arsyeshme se kanë ndryshuar pozitivisht kushtet e tregut në zonën ku ndodhet kjo pronë.

11. Procedura e rivlerësimit miratohet nga drejtorja e ATK-së pas një vlerësimi paraprak që kryen eksperti përkatës i këtij institucioni. Akti i ri i vlerësimit përgatitet nga eksperti i licencuar dhe shpenzimet i ngarkohen debitorit.

12. Si vlerë fillestare e pronës që do të shitet me ankand do të jetë vlera e ankandit të fundit të kryer nga përbaruesi gjyqësor ose ajo e rivlerësuar, e kontabilizuar në ATK.

13. Shitja me ankand e sendeve të kaluara në pronësi të ATK-së fillon pasi drejtorja vendos për një procedurë të tillë, duke përgatitur dhe publikuar njoftimin përkatës në Buletinin e Njoftimeve Publike, në faqen e internetit, në njësinë e organit të pushtetit vendor dhe në vende të dukshme pranë zyrave qendrore dhe atyre rajonale të ATK-së, si dhe në vendin ku ndodhet sendi.

14. Periudha e publikimit zgjat 21 ditë nga data e botimit të parë dhe bëhet në çdo botim të Buletinit të Njoftimeve Publike, brenda këtij afati.

15. Zyrrat rajonale të ATK-së ose specialisti i Drejtorisë së Përgjithshme të ATK-së, dërgojnë zyrtarisht në drejtori, procesverbalin për vendosjen e afisheve brenda afatit të botimit të njoftimit në Buletinin e Njoftimeve Publike.

16. Njoftimi për botim përmban të dhënat e mëposhtme:

- Vendin, datën dhe orën e zhvillimit të ankandit;
- Emërtimin dhe vendndodhjen e sendit që shitet;
- Vlerën fillestare të ankandit;
- Sipërfaqen e përgjithshme dhe atë nën objekt (për sendet e paluajtshme).

17. Pjesëmarrësit në ankand, pas regjistrimit të kërkesës në Drejtorinë e Përgjithshme të ATK-së, kanë të drejtë të verifikojnë dokumentacionin e pronësisë së sendit që do të shitet, i cili ndodhet i depozituar në këtë institucion, si dhe të njihen me gjendjen fizike të sendit në terren.

18. ATK-ja harton dhe arkivon një procesverbal, i cili përmban:

- Kopjen e buletinit;
- Datat e botimit të njoftimeve;
- Kopjen e njoftimit me afishe.

19. Pjesëmarrësit në ankand duhet të paraqesin në vendin, datën dhe orën e njoftuar, në komisionin e ankandit këto dokumente:

- a) Kërkesën me shkrim për blerjen e sendit;

b) Mandatpagesën, që vërtetohet derdhjen e 20 % të çmimit të sendit që do të shitet në ankand, në llogarinë bankare të ATK-së.

20. Kur për sendet e shpallura për shitje, sipas procedurave të këtij vendimi, nuk paraqitet asnjë kërkesë për blerjen e tyre, ATK-ja cakton një vlerë tjetër, më të ulët se vlera e shpalljes së ankandit të parë dhe zhvillon ankandin e dytë.

21. ATK-ja ka të drejtën e përsëritjes së ankandit të dytë deri në tri herë, duke ulur gradualisht çmimin e sendit deri në vlerën maksimale:

a) Për sendet e paluajtshme, deri në 30%;

b) Për sendet e luajtshme, deri 50%.

22. Në këto raste, sendi u nënshtrohet edhe një herë të gjitha procedurave të shitjes, të parashikuara në këtë udhëzim për ankandin e parë.

23. Pasi arrihet vlera maksimale e uljes dhe sendi nuk shitet, bëhet rivlerësimi i tij me ekspertë vlerësues të licencuar dhe më pas fillojnë procedurat e ankandit, në bazë të çmimit të ri.

24. Për rastet kur mbetet vetëm një blerës, si në publikimin me vlerë fillestare, ashtu edhe për rastin kur objekti është i publikuar me ulje vlere, sipas pikës 22 të këtij kapitulli, bëhet një njoftim i ri sipas përcaktimeve në pikën 13 të këtij kreu, për një periudhë 10-ditore. Pas këtij publikimi, në rast të mosparaqitjes së ndonjë ofertuesi tjetër, ATK-ja realizon shitjen e sendit tek ofertuesi i vetëm.

25. Procedurat për të gjitha rastet e parashikuara në këtë kapitull, fillojnë me miratimin e drejtorisë së ATK-së. Çdo element shtesë është pjesë e botimit.

26. Komisioni i ankandit kryesohet nga një zëvendës drejtor i përgjithshëm dhe përbëhet nga:

- Drejtori i Drejtorisë së Financës dhe Llogaritjes së Detyrimit;

- Drejtor i Drejtorisë së Migrimit dhe Koordinimit me Zyrat Rajonale;

- Përgjegjës i Administrimit të Objekteve të Sekuestruara;

- Përgjegjës i sektorit juridik.

27. Komisioni i ankandit, nën drejtimin e kryetarit të tij, ka këto detyra:

a) Prezanton anëtarët e komisionit të ankandit.

b) Regjistron dhe vërteton identitetin e pjesëmarrësve në ankand ose përfaqësuesve të tij me prokurë, sipas kartës së identitetit, pasaportës biometrike, certifikatës së gjendjes civile ose me prokurë të posaçme përfaqësimi.

c) Deklaron vlerën fillestare të ankandit.

ç) Deklaron hapin e dhënies së ofertave për vlerën fillestare për pjesëmarrësit në ankand, e cila është:

- jo më pak se 3% e vlerës fillestare, kur ajo është deri në 5 milionë lekë;

- jo më pak se 2% e vlerës fillestare, kur ajo është mbi 5 milionë lekë.

d) Drejton marrjen e ofertave.

e) Siguron që dhënia e ofertave të vazhdojë deri sa të ketë oferta të tjera, përpara shpalljes së fituesit.

f) Shpall personin e fundit, që deklaron çmimin më të lartë, si fitues i ankandit.

28. Komisioni i ankandit harton një procesverbal, i cili duhet të përmbajë:

a) emrat e anëtarëve të komisionit të ankandit;

b) regjistrimin e identitetit të pjesëmarrësve në ankand, sipas kartës së identitetit, pasaportës biometrike, certifikatës së gjendjes civile ose prokurës së posaçme të përfaqësimit;

c) deklarin e vlerës fillestare të ankandit;

ç) deklarin e hapit të dhënies së ofertave për vlerën fillestare për pjesëmarrësit në ankand;

d) marrjen e ofertave;

e) vazhdimin e dhënies së ofertave deri sa të ketë oferta të tjera, përpara shpalljes së fituesit;

f) shpalljen e personit të fundit që deklaron çmimin më të lartë, si fitues i ankandit.

Procesverbali i ankandit duhet të nënshtrohet nga anëtarët e komisionit dhe pjesëmarrësit në ankand për çdo ofertë të dhënë.

29. Pjesëmarrësit në ankand, që tërhiqen pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e sendit të shpallur për shitje, u konfiskohet garancia bankare. Pjesëmarrësve të tjerë në ankand, që kanë dhënë oferta, por nuk janë shpallur fitues, u kthehet garancia bankare.

30. Brenda 10 ditëve nga zhvillimi i ankandit, personi që ka fituar të drejtën e blerjes së sendit, njoftohet zyrtarisht për vendimin e marrë nga drejtoria e ATK-së për këtë qëllim dhe procedurat e mëtejshme të pajisjes me autorizim për kalim pronësie.

31. Brenda 30 ditëve nga data e zhvillimit të ankandit, blerësi është i detyruar të bëjë pagesën në lekë të pjesës së mbetur të çmimit fitues, pasi është zbritur vlera e garancisë bankare.

32. Të ardhurat e realizuara nga shitja në ankand deklarohen si arkëtime në evidencën statistikore dhe diferencat që rezultojnë në raport me vlerën e kontabilizuar, sistemohen si më poshtë:

- a) mbi vlerën e kontabilizuar, kalojnë në rezultatit financiar të ATK-së;
- b) nën vlerën e kontabilizuar, kalojnë për korrektimin e detyrimit të debitorit.

33. Nëse personi që është shpallur fitues, nuk paguan pjesën e çmimit të mbetur, brenda afatit të përcaktuar në pikën 31 të këtij kreu, humbet të drejtën e blerjes, si dhe të marrjes pjesë në ankandin, që do të zhvillohet për rishitjen e këtij sendi. Pagesa e ngurtësuar si garanci bankare për pjesëmarrje në ankand, i sekuestrohet, ndërsa çdo pagesë tjetër e bërë, i kthehet ofertuesit.

34. Sendi që rezulton i pashitur për shkak se personi i shpallur fitues, nuk paguan brenda afatit ligjor diferencën e çmimit të mbetur, pas zbritjes së vlerës së garancisë bankare, rishpallet për shitje duke zbatuar procedurat e publikimit të shitjes me ankand nga e para.

35. Pas pagesës nga fituesi të çmimit të arritur në ankand, ATK-ja lidh kontratën e shitjes me blerësin para noterit dhe bën dorëzimin e sendit me procesverbal të blerësi.

36. Në raste të veçanta, pas konsultimeve paraprake me organet e pushtetit vendor ose institucione të tjera shtetërore, që shprehin interes publik për marrjen me transferim kapital të sendeve në pronësi të ATK-së, i kërkohet Ministrisë të Financave të ushtrojë autoritetin e tij ligjor për të mundësuar kryerjen e këtyre veprimeve.

37. Nuk lejohen dhënia me qira dhe kalimi kapital i objekteve, që janë publikuar për shitje.

38. ATK-ja, në përputhje me kërkesat e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.681, datë 11.6.2009, ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.450, datë 16.6.2010 dhe këtij udhëzimi, ka të drejtë të hartojë rregulloren e brendshme për zhvillimin e ankandit, e cila miratohet me vendim të Këshillit Mbikëqyrës.

39. Shitjet me ankand të sendeve në pronësi të ATK-së apo transferimi kapital i tyre në organet e pushtetit vendor ose institucionet e tjera shtetërore, pasqyrohen si tregues të raportit statistikor.

KREU IV

1. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Agjencia e Trajtimit të Kredive.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, të gjitha aktet e tjera ekzistuese nënligjore, shfuqizohen.
3. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
PËRMBLEDHJE E AKTEVE NDËRKOMBËTARE PËR DREJTËSINË	660 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PASURITË E PALUAJTSHME	328 lekë
PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE	260 lekë
VENDIME UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 27.9.2010
Doli nga shtypi më 28.9.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 40 lekë